



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 77 Akti

Nr. 111 Vendimi
Tiranë, më 27.02.2019

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues, të përbërë nga:

Lulzim Hamitaj
Olsi Komici
Etleda Çiftja

Kryesues
Anëtar
Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Branko HRVATIN, më datë 25 shkurt 2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petrit Çeno, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi në seancë dëgjimore përfaqësuesit me prokurë të posaçme, Nr. (***) , datë 20 shkurt 2019, Av. Ravik Gurra dhe znj. Gloria Çeno, të subjekti të rivlerësimit dhe vëzhguesin ndërkombëtar, z. Branko HRVATIN, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno, i cili në seancë dëgjimore publike, me anë të përfaqësuesve të tij kërkoi konfirmimin e në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Petrit Çeno, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, referuar nenit 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/6, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

3. Z. Petrit Çeno si subjekt rivlerësimit është hedhur në short nga ana e Komisionit, më datë 15 janar 2018, me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Komisioner
Olsi Komici	Komisioner
Alma Faskaj	Relatore

4. Duke qene se znj. Alma Faskaj ka munguar për arsye shëndetësore, Komisioni, ka rihedhur në short çështjen e subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno, me komisioner/relator zëvendësues znj. Etleda Çiftja.

5. Menjëherë me hedhjen e shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31- 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “**DSIK**”), sipas ligjit 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “**KLD**”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

6. Trupi gjykues nr. 4, i shortuar më datë 15.01.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “**Komisioni**”), me vendimin nr. 1, datë 30.01.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesues të trupit gjykues, z. Lulzim Hamitaj; të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

7. Më datë 29.01.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çeno, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Më datë 30.01.2019, me anë të postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

9. Më datë 01.02.2019, subjekti i rivlerësimit njoftoi me anë të postës elektronike² se konfirmonte marrjen e njoftimit dhe kërkoi shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve përfundimtare. Komisioni i dha dhe një ditë shtesë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

10. Më datë 11.02.2019, subjekti i rivlerësimit, dërgoi me anë të postës elektronike pretendimet, provat dhe kërkesat paraprake mbi raportin e përfundimit të hetimeve³. Bashkë me pretendimet, subjekti i rivlerësimit i drejton Komisionit 13 kërkesa paraprake.

11. Më datë 15.02.2019, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çeno, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 21.02.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë. Në po të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Komisioni t'i japë përgjigje kërkesave paraprake të tij, para se të zhvillohet seanca dëgjimore.

12. Më tej, më datë 20.02.2019, Komisioni, njofton shtyrjen e datës së seancës dëgjimore për në datë 22.02.2019, ora 12:00, duke qenë se në median elektronike dhe atë të shkruar ishte njoftuar një protestë, e cila mund të shkaktonte pamundësinë e lëvizjes për në vendin se ku do të zhvillohej seanca dëgjimore. Ndërsa në lidhje me kërkesat paraprake të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, njoftoi subjektin se do të shprehet në lidhje me to gjatë seancës dëgjimore. Po në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit njoftoi me anë të postës elektronike se e kishte të pamundur të ishte fizikisht në seancë dëgjimore, më datë 22.02.2019, ora 12:00, duke pretenduar se do të udhëtonte jashtë Shqipërisë dhe për këtë do të paraqiste biletën e udhëtimit të tij.

13. Komisioni pas komunikimit të vazhdueshëm me subjektin në lidhje me datën e seancës dëgjimore, njofton subjektin, po më datë 20.02.2019, se seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e hënë, më datë 25.02.2019, ora 12:00, pranë pallatit të Kongreseve, kati 0 (zero), Tiranë.

14. Më datë 25.02.2018, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore në mungesë të subjektit të rivlerësimit dhe në prezencë të përfaqësuesve me prokurë të posaçme, Av. Ravik Gurra dhe znj. Gloria Çeno, sipas prokurës nr. (***), datë 20 shkurt 2019.

¹ *E-mail* i datës 30.01.2019, ora 15:20, "Komisioni - Njoftim mbi mbylljen e hetimit administrativ kryesisht për procesin e rivlerësimit", dërguar subjektit të rivlerësimit.

² *E-mail* i datës 01.02.2019, ora 14:56, "Komisioni - Njoftim mbi mbylljen e hetimit administrativ kryesisht për procesin e rivlerësimit", dërguar nga subjekti i rivlerësimit.

³ *E-mail* i datës 11.02.2019, ora 15:55, "Rivlerësimit rezultatet e relacionit", dërguar subjektit të rivlerësimit.

15. Në lidhje me kërkesën për pezullim të hetimit administrativ deri në momentin e përfundimit të hetimit dhe gjykimit të procesit penal, i cili mund të ndikojë sadopak në vendimmarrjen e Komisionit. Në frymën e Kodit Administrativ, çdo proces administrativ duhet të pezullohet në momentin kur para këtij procesi ka filluar një proces penal.

Komisioni, nuk pranon kërkesën e pezullimit të hetimit, për shkak se referuar nenit 66 të Kodit Procedurës Administrative, pezullimi i hetimit administrativ bëhet nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë. Duke qenë se procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit deri në momentin e ftesës për seancë dëgjimore, ishte përfunduar vetëm me kriterin e pasurisë, Komisioni, çmon se çështja penale referuar nga subjekti si proces penal, nuk është parakusht për zgjidhjen e procedurës së rivlerësimit në lidhje me një komponent siç është ai i vlerësimit të pasurisë.

16. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çeno, vetëm mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

17. Ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Petrit Çeno, merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Më datë 25.02.2019, u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të përfaqësuesve me prokurë të posaçme, Nr. (***) , datë 20 shkurt 2019, Av. Ravik Gurra dhe znj. Gloria Çeno, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko HRVATIN.

19. Seanca dëgjimore e datës 25.02.2019 u ndërpre, për të rifilluar më datë 27.02.2019, për shpalljen e vendimit.

20. Në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesit e subjekti i rivlerësimit kërkuan konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çeno, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

22. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

23. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit duke paraqitur pranë Komisionit një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe
- iii. KLD-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

24. Megjithëse sa më lart, referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

25. Me shkresën nr. (***)prot., datë 12.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno, i cili është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, me numër indeksi (***) dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

26. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, më datë 26.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- *Ka kryer fshehje pasurie;*
- *Ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

⁴ Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

27. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat e interesave private, periodike vjetore pranë ILDKPKI-së nga viti 2003 deri 2016 (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 11.02.2019, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

28. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

29. Mbi dorëzimin e deklaratës së pasurisë sipas ligjit nr. 84/2016 nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting” në zbatim të nenit 31/1⁵, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çeno, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personat e lidhur) në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 26.01.2017, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar.

Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

V/3. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit.

1. Në lidhje me pasurinë, apartament, me sip.98 m² dhe garazh, me sip. 22 m² .

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Deklarata e interesave private, për herë të parë, në vitin 2003;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga ZRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. (***)prot., datë 21.06.2018;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga ZRPP-ja Durrës, me shkresën nr. (***) prot., datë 10.02.2018;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me shkresën nr. (***) prot., datë 28.02.2018;

⁵Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

- ✓ Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë;
- ✓ Analizën financiare të kryer mbi bazën e dokumentacionit provues ligjor të vënë në dispozicion nga subjekti dhe të administruar nga hetimi administrativ kryesisht;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

1.1. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se ka në pronësi një apartament me sip. 98 m² dhe një garazh me sip. 22 m², blerë, më datë 16.04.2003, me palë shitëse: Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “A.” sh.p.k, në Tiranë, blerë në çmimin 1,960,000 lekë apartamenti + 460,000 lekë garazh. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratën e dokumentacionit shoqëruar.⁶

1.2. Burimi i krijimit për të dyja pasuritë: (i) Pagesa e këtyre pasurive është bërë nga kursimet e të ardhurave familjare para vitit 1997; (ii) një pjesë e mbetur nga shitja e një banese në Durrës e cila vërtetohet me kontratën e shitjes nr. (***) , datë 21.7.2003, shtëpi banimi, regjistruar pranë ZVRPP-së, më datë 14.12.1993, vol. 1, fq. (***) , banesë e privatizuar në vlerën 1,800 lekë (dhe më pas i është shitur blerëses A. B., në vlerën 5,600,000 lekë, më datë 21.07.2003).

1.3. ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. (***)prot., datë 21.06.2018, drejtuar Komisionit ka konfirmuar se në emër të Petrit dhe M. Ç. rezultojnë: Pasuria, nr. (***) , vol. (***) , fq. (***) , ZK (***) , lloji i pasurisë, apartament, me sip. 98 m², sipas kontratës së shitjes⁷ së pasurisë së paluajtshme me palë shitëse Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “A.” sh.p.k dhe blerës: Petrit dhe M. Ç.

1.4. Shitësi deklaroi se është likuiduar plotësisht për apartamentin jashtë zyrës së noterisë. Çmimi i shitjes i është paguar sipërmarrësit ndërtues shoqërisë “A.” sh.p.k., përpara redaktimit të kësaj kontrate⁸.

1.5. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme shitur znj. A. B., në vlerën 5,600,000 lekë, rezultoi se: ZVRPP-ja Durrës ka vënë në dispozicion kartelën e pasurisë për pasurinë apartament, me sip. 64.46 m², me adresë: Blv. (***) , pll. (***) , shk. (***) , k. (***) , ap. (***) , Durrës, nr. pas (***) ,vol. (***) , fq. (***) , ZK (***) . Kjo pasuri rezultoi e regjistruar, më datë 26.03.1998, në emër të Petrit dhe M. Çenos e cila më pas është tjetërsuar në emër të znj. A. B., regjistruar, më datë 26.09.2003.

1.6. Kartelë ku rezultoi pasuria, apartament, me sip.38.50 m², me adresë: Blv. (***) , shk. (***) , k. (***) , ap. (***) , Durrës, nr. pasurisë (***) , vol. (***) , fq. (***) , ZK (***) . Kjo pasuri rezultoi e regjistruar, më datë 18.07.2003, në emër të z. Petrit Çeno, e cila më pas është tjetërsuar në emër të znj. A. B., regjistruar, më datë 26.09.2003.

1.7. Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. (***) , datë 21.07.2003, me palë shitëse Petrit dhe M. Ç. dhe blerës A. B., si vijon:

1.7.1 Apartament, me sip. 64.46 m², përbërë nga një dhomë + kuzhinë dhe ambiente ndihmëse;

⁶ Kontratë shitje nr. (***) , datë 14.04.2003, me shitës Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “A.” sh.p.k., dhe blerës Petrit dhe M.Çeno, për pasurinë, apartament, me sip. 98 m², ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, çmimi 1.960.000 lekë; Vërtetim hipotekor, datë 02.04.2003, për apartament, me sip. 98 m², në ZK(***) , në pronësi të Gjykatës së Apelit Tiranë + harta treguese; Vërtetim hipotekor, datë 17.04.2003, për apartament, me sip. 98 m², në ZK (***) , në pronësi të Petrit dhe M. Çeno + harta treguese; Kontratë shitje nr. (***) , datë 16.04.2003, me shitës Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “A.” sh.p.k., dhe blerës Petrit dhe M.Çeno, për garazh me sip. 22 m², ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, çmimi 4.600.000 lekë; Vërtetim hipotekor, datë 02.04.2003, për garazh me sip. 22 m², në ZK (***) , në pronësi të Gjykatës së Apelit Tiranë + harta treguese; Vërtetim hipotekor, datë 17.04.2003, për garazh, me sip. 22 m², në ZK (***) , në pronësi të Petrit dhe M. Ç.+ harta treguese.

⁷ Kontrata e shitjes nr. (***) , datë 14.04.2003, me shitës Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “A.” sh.p.k., me çmim 1,960,000 lekë.

⁸ Neni 4 i kontratës “Çmimi dhe mënyra e pagesës”, pika 4.2 e saj.

1.7.2 Shtesë, me sip. 30 m², prej 2 dhoma dhe një ballkon. Me çmimin total 5,600,000 lekë.

1.8. Shtesë, me sip. 30m², prej 2 dhomash dhe një ballkon, nuk është deklaruar në deklarimin e interesave për herë të parë në vitin 2003.

1.9. Apartamenti me sip. 64.46 m² është përfituar nga kontrata e shitblerjes, datë 13.12.1993, me shitës Ndërmarrje Komunale Banesa dhe palës blerëse Petrit dhe M.Ç., kundrejt çmimit 12,775 lekë.

1.10. Shtesa me sip. 30 m² me ambiente ndihmëse është përfituar nga:

a) Vendimi për dhënie sheshi ndërtimi, nr. (***), datë 20+21.05.1996, i Qarkut Durrës që miraton dhënien e sheshit të ndërtimit me sip. 30 m²;

b) Leja e ndërtimit lëshuar nga Këshilli i Qarkut Durrës, datë 15.10.1996, sipas vendimit të KRRT-së, nr. (***), datë 19+27.09.1996, si shtesë për pallatin nr. (***), shoqërisë “S.” sh.p.k;

c) Procesverbalit, datë 27.03.2003, mbajtur nga zyra e urbanistikës Durrës, që konfirmon se ndërtimi i shtesës ka përfunduar;

d) Lejes së shfrytëzimit, nr. (***), datë 27.03.2003, lëshuar nga Seksioni i Urbanistikës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për shtesën anësore në pallatin nr. (***);

e) Kontratë për shitje trualli nr. (***), datë 14.07.2003, lidhur me palë shitëse Seksioni i Financës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe palës blerëse 6 banorëve të pallatit ku përfshihet dhe z. Petrit Çeno.

1.11. Subjekti ka deklaruar se 65.7 % e shumës, burim krijimi, ka qenë nga shitja e apartamentit në Durrës, datë 21.07.2003, në një kohë kur apartamenti me sip.98 m² dhe garazh me sip. 22 m² janë blerë më përpara se të shitej shtëpia në Durrës.

1.12. ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. (***), datë 21.06.2018, drejtuar Komisionit ka konfirmuar se në emër të Petrit dhe M. Ç. rezultojnë: Pasuria nr. (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), lloji i pasurisë garazh me sip. 22 m²⁹, sipas kontratës së shitblerjes¹⁰ po me palë shitëse: Gjykata e Apelit Tiranë dhe “A.” sh.p.k., dhe palës blerëse Petrit dhe M. Ç. Shitësi deklaroi se është likuiduar plotësisht për apartamentin jashtë zyrës së noterisë. Çmimi i shitjes i është paguar sipërmarrësit ndërtues shoqërisë “A.” sh.p.k., përpara redaktimit të kësaj kontrate.

1.13. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, është konstatuar se të ardhurat nga paga deri në vitin 1997 për subjektin e rivlerësimit janë në shumën 994,878 lekë sipas dokumentacionit ligjor shoqëruar, sipas tabelës më poshtë:

Të ardhurat deri në vitin 1997	Shumat në lekë
Subjekti	994,878
Bashkëshortja ¹¹	-

1.14. Në tabelën e të ardhurave të konsideruara nga Komisioni, nuk janë zbritur shpenzimet e jetesës, pasi subjekti nuk dërgoi informacion dhe pse është pyetur në lidhje me këto me anë të postës elektronike.

1.15. Subjekti “L.” sh.p.k., i themeluar në vitin 1994 është regjistruar pranë QKB-së në vitin 1999 dhe për periudhën deri në vitin 1997 nuk ka të dhëna lidhur me fitimet e gjeneruara nga kjo shoqëri.

1.16. Shoqëria “G.” sh.p.k., pas verifikimit në sistemin e tatimeve nuk rezulton që ky subjekt të jetë regjistruar në DRT-në Durrës.

⁹ Shkresa e ZVRPP-së ka të shënuar sip.98 m² që është lapsus, pasi duke u bazuar te kartela e pasurisë dhe kontrata e shitjes nr. (***), datë 16.04.2003, garazh ka sip. 22 m².

¹⁰ Kontrata e shitjes nr. (***), datë 16.04.2003.

1.17. Gjithashtu M.Ll. (Ç.) person fizik me aktivitet “Furrë buke” dhe tregti konfeksione nuk ka dorëzuar deklaratat për fitimin e vitit.

1.18. Bazuar në faktet e hetimit administrative, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar bashkërisht në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

1.19. Në deklaratën e interesave privat, për herë të parë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e blerjes së apartamentit dhe garazhit.

1.20. Më datë 11.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka dërguar prapësimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit administrative kryesisht, në lidhje me këtë aset.

1.21. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

1.22. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme nga të ardhurat familjare para vitit 1997, të ardhura që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi.

1.23. Subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje deklarimi për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, për shkak se në deklaratën e bërë nga subjekti, si në deklaratën “Vetting”, ashtu dhe në deklaratën e vitit 2003, se burimi i krijimit, sipas subjektit është “nga shitja e shtëpisë në Durrës në vlerën 5,600,000 lekë sipas kontratës së shitjes së datës 21.07.2003”, ndërkohë që subjekti pasuritë, apartament me sip. 98 m² dhe garazh me sip. 22 m² i ka blerë me kontratën e shitjes së datës 14.04.2003, dhe në kontratë është përcaktuar se çmimi i shitjes i është paguar sipërmarrësit përpara redaktimit të kësaj kontrate.

1.24. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e blerjes së këtij apartamenti dhe garazhi në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2003.

1.25. Subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje të vlerës së deklaruar të garazhit pasi: (i) në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar, garazh, me sip. 22 m², në vlerën 460,000 lekë; ndërkohë (ii) duke iu referuar kontratës së shitblerjes tek noteri¹² depozituar nga vetë subjekti (me nënshkrimin e tij), në dosjen e ILDKPKI-së të kjo kontratë në fq. (***) neni 4, “Çmimi dhe mënyra e pagesës” është vendosur çmimi 4,600,000 lekë i shkruar edhe me fjalë (katër milionë e gjashtëqind mijë); (iii) ndërkohë referuar përgjigjes së dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë me shkresën e saj nr. (***)prot., datë 21.06.2018, ka bashkëngjitur kontratën e garazhit me sip. 22 m², kontrata me të njëjtat nr. (***) datë 16.04.2003, tek e njëjta notere E. M., ku në fq. 2, neni 4, “Çmimi dhe mënyra e pagesës”, është vendosur çmimi 460,000 lekë i shkruar dhe me fjalë (katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

1.26. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues bashkëlidhur mandatarkëtimit lëshuar nga shoqëria “A.” sh.p.k., nr. (***) datë 30.01.1997 dhe nr. (***) datë 22.04.1998, për të provuar pagesën e kryer. Mandatpagesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk përbëjnë provë të plotë shkresore, për të vërtetuar se kjo shumë është arkëtuar në këtë kohë sipas legjislacionit. Këto mandatpagesa mund të sigurohen lehtësisht.

1.27. Personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit nuk ka dokumentacion justifikues për të vërtetuar të ardhurat/fitimin neto nga shoqëritë “L.” sh.p.k., “G.” sh.p.k., si dhe për aktivitetin “Furrë buke” dhe tregti konfeksionesh, të ardhura të cilat deklarohen si burim krijimi. Vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit, pranon se nuk disponon dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me këto të ardhura.

Për sa i përket pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit se:

1.28 Në lidhje me konstatimet e Komisionit, se ka mospërputhje të vlerës së paguar për garazhin me sip. 22 m², pasi: (a) në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar, garazh me sip. 22 m², në vlerën 460,000 lekë; ndërkohë... (b) duke iu referuar kontratës së shitblerjes tek

¹² Kontrata e shitjes nr. (***) datë 16.04.2003

noteri¹³ depozituar nga vetë subjekti (me nënshkrimin e tij) në dosjen e ILDKPKI-së, tek kjo kontratë në fq. (***) , neni 4 ,“Çmimi dhe mënyra e pagesës”, është vendosur çmimi 4,600,000 lekë, i shkruar edhe me fjalë (katër milionë e gjashtëqind mijë); (c) ndërkohë referuar përgjigjes së dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë me shkresën e saj, nr. (***) prot., datë 21.06.2018, ka bashkangjitur kontratën e garazhit me sip. 22 m², kontrata me të njëjtat nr. (***) , datë 16.04.2003, tek e njëjta Notere E. M. ku në fq. (***) , neni 4 “Çmimi dhe mënyra e pagesës” është vendosur çmimi 460,000 lekë i shkruar dhe me fjalë (katërqind e gjashtëdhjetë mijë).

Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, shpjegoi se: *“Duke vlerësuar çmimin e tregut në periudhën që është porositur apartamenti është absolutisht e pamundur që të blihet garazhi me sip. 22 m² në një vlerë shumë herë më të madhe sesa ai i apartamentit. Duke qenë që vlera është e ndryshme në kontratën që ne disponojmë me atë që është depozituar pranë ZVRPP-së mendojmë që është një gabim material”*.

Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, shpjegoi bindshëm mospërputhjet dhe gjithashtu pranon shpjegimet e subjektit se është një gabim material. Në këto kushte, Komisioni, refuzoi kërkesën, nr. 03, të subjektit për të marrë në pyetje ose për të kërkuar informacion nga firma e ndërtimit “A.” sh.p.k., në lidhje me pagesat e kryera, për shkak se nuk ishte e nevojshme.

1.29 Për sa i përket shoqërisë “G.” sh.p.k., fitimi gjatë periudhës 1994 -1996 nga bashkëshortja M.Ç. është vetëdeklaruar, në vlerën 6,200,000 lekë, duke marrë në konsideratë:

- Për vitin financiar 1994 – shumën prej 700,000 lekësh;
- Për vitin financiar 1995 – shumën prej 2,500,000 lekësh; dhe
- Për vitin financiar 1996 – shumën prej 3,000,000 lekësh.

Komisioni, vlerëson se vetëdeklarimi i bërë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. Ç., nuk vërteton se të ardhurat e përfituara nga ajo janë të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës i cili parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe neni 3, pika 19, e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuar në ligjin mbi “Tatimin mbi të ardhurat”*.

Referuar shkresës nr. (***)prot., datë 28.02.2018, administruar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, personi i lidhur, znj. M. Ç., ka dokumentacion në lidhje me shoqërinë “L.O.” sh.p.k., për pagimin e tatimeve nga viti 2008 deri në vitin 2017, dhe jo sikundër pretendon subjekti për vitet 1994 -1996. Ndërkohë që nuk figuron asnjë informacion në lidhje me sa subjekti i rivlerësimit pretendon për shoqërinë “G.” sh.p.k.

1.30 Më tej subjekti në përgjigje të pyetësorit, datë 18.01.2019, ka deklaruar se: *“Për këto vite për shkak të trazirave të vitit 1997, e gjithë arkiva dhe dokumentacioni i mbajtur pranë zyrës në portin e Durrësit u dogj”*

Komisioni, vlerëson se subjekti nuk shpjegoi apo provoi bindshëm se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin, dhe se institucionet shtetërore nuk përgjigjen brenda afatit ligjor, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.”* Subjekti i rivlerësimit jo vetëm që nuk provoi pamundësinë, por nuk provoi gjithashtu se institucionet shtetërore nuk janë përgjigjur brenda afatit.

¹³ Kontrata e shitjes, nr. (***) , datë 16.04.2003.

1.31 Në lidhje me kopjet e librezës së punë për sigurimet shoqërore të paguara për periudhën 01.04.1989 - 31.08.1993, pranë Ndërmarrjes Bujqësore Frutore Durrës, si dhe nga vërtetimi i lëshuar nga ISSH-ja Durrës, për periudhën 21.11.1994 - 30.04.1996, vërtetohet se znj. M. Ç.(Ll.) ka paguar sigurimet shoqërore në përputhje me legjislacionin e kohës; Komisioni nuk është në gjendje të identifikojë se sa kanë qenë të ardhurat e përfituara nga znj. M. Ç., me qëllim llogaritjen e tyre si të ardhura deri në vitin 1997, nëse nuk vërtetohen nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Durrës. Neni 3, pika 19, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *“Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuar në ligjin mbi “Tatimin mbi të ardhurat”.*

1.32 Në lidhje me provat e tjera, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar të ardhurat nga shoqëria “G.” sh.p.k., si: (i) Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për regjistrimin e personit fizik, agjenci doganore “G.” sh.p.k., nr. (***) , datë 20.10.1994; (ii) Vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr(***)prot., datë 07.01.1994, për miratimin e Agjencisë Doganore “G.” sh.p.k; (iii) Mandatarkëtimet për hapjen e numrit të llogarisë pranë “BKT”-së, datë 03.02.1995; dhe (iv) Mandatarkëtimet për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të kryera në datat 22.11.1994 dhe 17.06.1995, për të provuar të ardhurat nga shoqëria “G.” sh.p.k.

Komisioni çmon se, ky dokumentacion i paraqitur nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk provon dot të ardhurat e ligjshme sipas parashikimeve të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës, për shkak se asnjë nga këto dokumente nuk provon se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka paguar detyrimet tatimore.

1.33 Në lidhje me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë në mënyrë të përsëritur disa kërkesa në lidhje me marrjen e informacionit për pagimin e tatimeve, por që nuk ka pasur një përgjigje brenda afatit ligjor.

Komisioni arsyeton se, subjekti i rivlerësimit, nuk provoi se Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës kishte marrë në dorëzim kërkesën për informacion në lidhje me shoqërinë “G.” sh.p.k., ndërkohë që për shoqërinë “L.” sh.p.k., institucioni shtetëror/ Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, ka kthyer përgjigje sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, pretendimi i subjektit është i pabazuar në prova.

1.34 Në lidhje me kërkesat paraprake, paraqitur bashkë me prapësimet përfundimtare, për (1) marrjen e informacionit nga Bashkia Durrës, zyra e taksave vendore në lidhje me taksat bashkiake të thjeshtuara për subjektin, agjencia doganore "G.", Person Fizik në emër të znj. M.Ç. (Ll.), për periudhën 1994 – 1996; si dhe (2) marrjen e informacionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për rinovimin vjetor të licencës për agjenten doganore, znj. M. Ç., për periudhat 1994 -1996.

Komisioni, refuzon kërkesat për marrje informacioni nga institucionet shtetërore, pasi bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ai që ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e shkresës së dërguar nga Drejtoria e Tatimeve se nuk ka informacion në lidhje me pagimin e taksave, është subjekti i rivlerësimit dhe jo Komisioni. Për më tej, këto kërkesa janë të panevojshme, pasi faktet në lidhje me pagimin e tatimeve janë vërtetuar nga shkresat e administruara nga Drejtoria Rajonale Durrës gjatë hetimit administrativ, dhe Komisioni vendos mbi bazën e provave që disponon.

1.35 Në përfundim, Komisioni, arrin në konkluzionin se, subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çeno:

- i. Nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe garazhit. Sipas nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.*

- ii. Ka fshehur vlerën e blerjes së këtij apartamenti dhe garazhi, ndodhur në, Rr. “(***)” në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, të vitit 2003;
- iii. Ka kryer deklaram të rremë në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi në Tiranë, në prill të vitit 2003, pasi të ardhurat nga shitja e banesës në Durrës janë përfituar nga subjekti në korrik të vitit 2003;
- iv. Ka kryer deklaram të rremë në lidhje me apartamentin e shitur sipas kontratës nr. (***), datë 21.07.2003, pasi objekt i kësaj kontrate shitjeje nuk është vetëm banesa e përfituar nga privatizimi, por edhe shtesa anësore me sip. 30 m², në pallatin nr. (***), Rr. “(***)”, Durrës;
- v. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi.

2. Në lidhje me pasurinë, apartament, me sip. 79 m², ndodhur në, fshatin K., Komuna Golem, Kavajë.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017, dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Deklaratën e interesave private, për herë të parë, në vitin 2003 dhe atë vjetore të vitit 2004;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga ZRPP-ja Kavajë, me shkresën nr. (***)prot., datë 12.02.2018;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga Drejtoria e Rajonale Tatimore Durrës, me shkresë nr. (***) prot., datë 28.02.2018;
- ✓ Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë;
- ✓ Analiza financiare e kryer mbi bazën e dokumentacionit provues ligjor të vënë në dispozicion nga subjekti dhe të administruar nga hetimi administrativ kryesisht;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

2.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, ka përfituar shumën prej 38,000 eurosh nga shitja e apartamentit me sip. 79 m², ndodhur në K., Komuna Golem, Kavajë, në vitin 2007. Ky apartament, deklaroi subjekti, është blerë me kontratën nr(*), datë 01.07.2003, me palë shitëse B. K. dhe palë blerëse Petrit dhe M. Ç. Kjo pronë është shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 08.05.2007, me palë shitëse Petrit Çeno dhe M. Ç. dhe palë blerëse L. F. M., në vlerën 38,000 euro. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues.¹⁴**

2.2 Burimi i krijimit: Subjekti ka depozituar: Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme me nr. (***), datë 01.07.2003, me shitës B. K. dhe blerës Petrit Çeno dhe M. Ç. për blerjen e apartamentit me sip. 79 m², në K., Kavajë, me nr. pasurie (***), ZK (***). Çmimi i blerjes në vlerën 1,980,000 lekë, likuiduar “jashtë zyrës noteriale”.

¹⁴ Kontratë shitblerje nr. (***), datë 01.07.2003, për blerjen nga Petrit dhe M. Ç. të apartamentit me sip. 79 m², në fshatin K., Kavajë, në vlerën 1.980.000 lekë. Kontratë shitjeje nr. (***), datë 08.05.2007, për shitjen nga ana e Petrit dhe M. Ç. të apartamentit me sip. 79 m², në ZK (***), vol. (***), fq. (***), fshati K., Kavajë, në vlerën 38.000 euro.

2.3 Në përgjigje të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se, sipas kontratës, pagesa në vlerën prej 1,980,000 lekësh, është krijuar nga shitja e apartamentit në Durrës nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 21.07.2003, i cili u shit në vlerën 5,600,000 lekë.

2.4 Në deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi se e ka blerë këtë apartament nga të ardhurat familjare.

2.5 Kontratë shitblerje apartamenti, nr. (***) , datë 08.05.2007, me shitës Petrit Çeno dhe M. Ç. dhe blerës L. M., për apartamentin me nr. pasurie (***) , ZK(***) . Çmimi i shitjes në vlerën 38,000 euro, i cili deklarohet nga palët dhe do të realizohet nëpërmjet “Bankës Amerikane”, dega Tiranë.

2.6 ZVRPP-ja Kavajë, me shkresën nr. (***)prot., datë 12.02.2018, drejtuar Komisionit, ka dërguar informacionin dhe dokumentacionin në lidhje me pasuritë¹⁵, duke konfirmuar pronësinë dhe kontratën me të cilën është blerë.

2.7 Kjo pasuri e paluajtshme më pas është tjetërsuar ku, me kontratën e shitblerjes së apartamentit, nr. (***) , datë 08.05.2007, me shitës Petrit Çeno dhe M. Ç. dhe blerës L. M., për apartamentin me nr. pasurie (***) , ZK (***) . Çmimi i shitjes në vlerën 38,000 euro, i cili deklarohet nga palët dhe do të realizohet nëpërmjet “Bankës Amerikane”, dega Tiranë.

2.8 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat familjare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, sipas deklaratës për herë të parë të vitit 2003, deri në qershor të vitit 2003 është konstatuar se të ardhurat nga paga deri në qershor të vitit 2003 janë në vlerën **397,260 lekë** për subjektin e rivlerësimit, ndërsa për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, edhe sikur të marrim të mirëqenë faktin se gjatë vitit 2003 subjekti “L.” sh.p.k., ka gjeneruar një fitim në shumën prej **1,223,587 lekësh**, dhe duke marrë në konsideratë se pjesa takuese e fitimit për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit është 11 %, pjesa takuese e fitimit të saj është **shuma 134,595 lekë** dhe nëse marrim në konsideratë periudhën deri në qershor të vitit 2003, ky fitim rezulton të jetë **në vlerën 67,298 lekë**. Për më tepër, referohu tabelës më poshtë:

Të ardhurat 01.01.2003 - 30.06.2003	Shumat në lekë
Subjekti nga pagat	397,260
Bashkëshortja nga fitimi në agjencinë doganore Shoqëria “L.” sh.p.k.	67,298
Total	464,558

2.9 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

2.10 Subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit të blerjes së këtij apartamenti duke krahasuar deklarin në vitin 2003 dhe deklarin e bërë në përgjigje të pyetësorit. Në deklarin e vitit 2003, subjekti deklaroi: “*e kam blerë nga të ardhurat familjare*”, ndërkohë që në vitin 2019 në përgjigje të pyetësorit deklaroi se: “*e ka blerë nga të ardhurat e shitjes së shtëpisë në Durrës*”. Sipas dokumentacionit të administruar nga ZRPP-ja Kavajë, ky apartament është blerë më datën 1 korrik 2003, kurse shtëpia e ndodhur në Durrës është shitur në datën 7 korrik 2003.

¹⁵ Në emër të M. dhe Petrit Çenos ka qenë e regjistruar pasuria, apartament me sip. 79 m², me nr. pasurie (***) , vol. (***) , fq. (***) , ZK (***) , fituar me kontratë shitblerjeje, pasurie e paluajtshme me nr. (***) , datë 01.07.2003, me shitës B. K. dhe blerës Petrit Çeno dhe M. Ç., për blerjen e apartamentit me sip. 79 m², në K., Kavajë, në ZK (***) , nr. pasurie (***) . Çmimi i blerjes në vlerën 1,980,000 lekë, likuiduar “jashtë zyrës noteriale”.

2.11 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e blerjes së apartamentit në deklaratën e interesave privatë, për herë të parë në vitin 2003, me qëllim fshehjen e burimit të të ardhurave.

2.12 Çmimi i blerjes së këtij apartamenti në shumën prej 1,980,000 lekësh “jashtë zyrës noteriale”, çmim i cili është sa gjysma e çmimit referues për banesa sociale sipas udhëzimit nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë”. Për qytetin e Kavajës, çmimi në tregun e lirë për apartamentet është në vlerën 45,246 lekë/m². Kështu që, 79 m² x 45,246 lekë/m² = 3,574,437 lekë. Pra, apartamenti është blerë me vlerë gati 50 % më lirë. Ajo çka e përforcon më tej këtë fakt është shitja e po të njëjtit apartament në vitin 2007 me një vlerë prej 38.000 eurosh.

2.13 Ka pasaktësi në deklarime gjatë viteve 2003, 2004 e në vazhdim në lidhje me deklarimin e pakësimeve dhe shtimeve sipas ligjit për deklarimin e pasurisë. Referuar deklaratës së vitit 2007, subjekti deklaron se, ka shitur këtë apartament në shumën prej 38.000 eurosh, por pa deklaruar se si e ka shpenzuar këtë shumë, duke qenë se nuk e ka deklaruar si gjendje likuiditeti (cash ose bankë) në fund të vitit 2007.

2.14 Sipas analizës financiare për vitin 2003 në tërësi, rezulton se, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të të ardhurave të ligjshme shoqëruar me dokumentacion justifikues në shumën prej 3,428,871 lekësh.

Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni, arsyeton se:

2.15 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me çmimin e ulët të blerjes së këtij apartamenti, pretendon se ky konstatim nuk është i vërtetë. Edhe pse Komisioni ka marrë vlerën e tregut në atë periudhë kohe në zonën e Kavajës, ajo si vlerë reference është për qytetin e Kavajës dhe jo për rrethinat. Subjekti, gjithashtu ka bashkëlidhur dy kontrata të ngjashme të cilat janë bërë përafërsisht në të njëjtën periudhë kohe dhe kanë përafërsisht të njëjtën vlerë monetare për m². *Komisioni, në lidhje me këtë pretendim të subjektit arsyeton se, konstatimi i bërë nga ana e Komisionit është bazuar në dokumentacion provues, duke krahasuar kontratën e blerjes me çmimin mesatar të ndërtimit në atë zonë, çmim i cili është për banesa sociale me kosto minimale të tregut. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion deklarimin e tij. Sipas pretendimit të subjektit, firma ndërtuese ka bërë ndërtimin e këtij apartamenti pa asnjë fitim, duke qenë se çmimi është shumë i ulët.*

2.16 Në lidhje me kërkesën e subjektit, se Komisioni duhet të kërkojë pranë zyrës së avokatisë në të cilën janë nënshkruar kontratat dhe në zyrën e notarisë në të cilën janë nënshkruar dhe regjistruar këto kontrata, për kontrata shitblerje të ngjashme, në atë periudhë kohe për të njëjtën godinë banimi, Komisioni, e ka refuzuar si të panevojshëm në këtë rast.

2.17 Sipas analizës financiare, të ardhurat në total të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së subjektit për periudhën 1 janar deri më 30 qershor 2003, janë në shumën 464,558 lekë dhe duket qartë se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për vitin 2003 për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti. Për më shumë, referohu tabelës më poshtë:

	Përshkrim	Viti 2003
1	PASURI 01.01.2003 – 30.06.2003	3,572,000
	Banesë 2+1, me sip .98 m ² , Rr. “(***)” dhe garazh ^[1]	1,592,000

^[1] Në përgjigje të pyetësorit është deklaruar e shlyer vlera prej 1,592,000 lekësh, por si burim nuk mund të ketë shërbyer shtëpia e shitur në korrik, ndërsa ky apartament është blerë që në prill të vitit 2003.

	Apartament në Kavajë, me sip.78 m ²	1,980,000
2	TË ARDHURA 01.01.2003 – 30.06.2003	464,558
	Të ardhura nga pagat e subjektit të dokumentuara	397,260
	Të ardhura nga bashkëshortja të dokumentuara	67,298
3	SHPENZIME JETESE 01.01.2003 – 30.06.2003	321,429
	Shpenzime jetese ^[2]	321,429
	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 2-1-3)	-3,428,871

2.18 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çeno, nuk shpjegoi bindshëm se përse çmimi i blerjes së këtij apartamenti është nën koston mesatare të ndërtimit të banesave sipas udhëzimit të vitit 2003, duke pasur parasysh këtu dhe faktin se i njëjti apartament është shitur në vitin 2007 për një vlerë prej 38.000 eurosh.

2.19 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues nga burime të ligjshme deri në qershor të vitit 2003, në shumën -3,428,871 lekë, për të blerë këtë apartament.

2.20 Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të rremë në lidhje me burimin e krijimit, për shkak se ka deklarime të ndryshme në periudha të ndryshme.

2.21 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë apartament.

3. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme të personit të lidhur/bashkëshortes, apartament, me sip. 144 m², Rr. “(*)”, pallati “(***)”, Tiranë.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Deklaratën e interesave privatë, periodike vjetore, në vitin 2008, 2009;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. (***)prot., datë 21.06.2018;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga shoqëria “(***)” sh.p.k., më datë 06.08.2018;
- ✓ Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë;
- ✓ Analiza financiare e kryer mbi bazën e dokumentacionit provues ligjor të vënë në dispozicion nga subjekti dhe të administruar nga hetimi administrativ kryesisht;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

3.1. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, deklaroi se ka në pronësi një apartament me sip.144 m², Njësia Administrative Nr. (***), Rr. “(***)”, pallati “(***)”, shk. (***), k. (***), ap. (***), lidhur me shoqërinë “Sh.”

^[2] Shpenzime jetese nga ILDKPKI-ja sipas anketës së buxhetit të familjes deri më datë30.06.2003.

sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 14.02.2009, si dhe garazh (vlera sipas kontratës së sipërmarrjes 172,500 euro ap. + 24,000 euro garazhi = 196,500 euro).

3.2. Si burim krijimi, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar: (i) Kësti i I-rë, në vlerën prej 49,000 eurosh të krijuara nga kursimet e familjes; (ii) Kësti i II-të, në vlerën prej 60,000 eurosh është paguar me anë të kredisë së marrë pranë “Alpha Bank”, datë 28.01.2010; (iii) Kësti i III-të, në vlerën prej 60,000 eurosh në vitin 2014, shumë e krijuar pjesërisht nga kontrata e shitblerjes së një banese (me palë shitëse M. Ç. dhe blerës R. C., me vlerë 5,349,143 lekë, sipas kontratës së datës 12.02.2013), dhe pjesa e mbetur nga kontrata e shitblerjes, me palë shitëse M. Ç. dhe blerës E.dhe K. K., në shumën prej 95,000 eurosh (kontratë e datës 18.11.2014).

3.3. Vlera: Subjekti nuk ka vendosur vlerë përfundimtare se sa ka paguar, përveç shënimit se, *“pjesa e mbetur do të paguhet në momentin e regjistrimit të pronës pranë ZVRPP-së”*

3.4. Subjekti ka depozituar: Aktmarrëveshje (kontratë sipërmarrje) datë 14.02.2009, lidhur me shoqërinë “Sh.” sh.p.k., dhe porositësen M. Ç. për ndërtimin e apartamentit.

3.5. ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. (***) prot., datë 21.06.2018, drejtuar Komisionit, ka konfirmuar se, në emër të Petrit dhe M.Ç. rezultojnë të regjistruar vetëm apartamenti me sip. 98 m² dhe garazhi me sip. 22 m² (ndodhur në Rr. “(***)”) dhe nuk rezulton e regjistruar pasuri tjetër e paluajtshme. Pra, kjo pasuri e paluajtshme nuk rezulton ende të jetë e regjistruar pranë ZVRPP-së.

3.6. Shoqëria “Sh.” sh.p.k., më datë 06.08.2018, ka dërguar pranë Komisionit aktmarrëveshjen (kontratë sipërmarrje) datë 14.02.2009, lidhur midis shoqërisë “Sh.” sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit, dhe znj. M. Ç. me cilësinë e porositësit për blerjen e apartamentit me sip. bruto 143.75 m². (143.75 m² x 1200 euro) = 172,500 euro. Sipërfaqja e garazhit është 20 m² dhe vlera e tij është 24,000 euro.

3.7. Shoqëria “Sh.” sh.p.k., gjithashtu ka bashkëlidhur mandatarkëtimet (me numër ekstra) të pagesave të bëra nga znj. M. Ç. në arkën e shoqërisë “Sh.” sh.p.k., në monedhën lekë, si më poshtë:

1. Data 08.11.2008, shuma 1,200,000 lekë;
2. Data 01.12.2008, shuma 1,400,000 lekë;
3. Data 20.12.2008, shuma 1,100,000 lekë;
4. Data 15.01.2009, shuma 1,300,000 lekë;
5. Data 31.01.2009, shuma 1,200,000 lekë.

3.8. Më datë 03.03.2010, znj. M. Ç., ka paguar shumën 58,600 euro, për shoqërinë “Sh.” sh.p.k., nëpërmjet kredisë tek “Alpha Bank”.

3.9. Shoqëria, gjithashtu ka bashkëlidhur mandatarkëtimet e bëra në monedhën euro nga znj. M. Ç. për shoqërinë “Sh.” sh.p.k., si më poshtë:

1. Data 07.01.2015, shuma 5,000 euro;
2. Data 24.02.2015, shuma 5,000 euro;
3. Data 05.04.2015, shuma 5,000 euro;
4. Data 30.05.2015, shuma 7,000 euro;
5. Data 13.06.2015, shuma 5,000 euro;
6. Data 11.07.2015, shuma 4,000 euro;
7. Data 09.08.2015, shuma 6,000 euro;
8. Data 03.11.2015, shuma 5,000 euro.

3.10. Në lidhje me këto pagesa, shoqëria “Sh.” sh.p.k., deklaroi se:

- i. pagesat e bëra sipas pikës 2, që në total shkojnë në vlerën 6,200,000 lekë, konvertuar me kursin 126.1 euro = 49,167 euro, shlyejnë këstin e parë të kontratës së datës 14.02.2009;
- ii. Pagesa 58,600 euro bërë te “Alpha Bank”, më datë 03.03.2010, shlyen këstin e dytë;
- iii. Pagesat në arkë bërë në monedhën euro sipas pikës 4 në total përbëjnë vlerën 42,000 euro;

iv. Totali i këtyre pagesave, vërtetuar me këtë dokumentacion, është në vlerën 149,767 euro.

3.11. Shoqëria “Sh.” sh.p.k., deklaroi se, vlera e likuiduar nga blerësi është 172,226 euro, nga të cilat 149,767 euro, janë me dokumentacion justifikues, ndërsa për pjesën e mbetur prej 22,459 eurosh, shoqëria nuk disponon mënyrën e pagesës/mandatet.

3.12. Sipas të njëjtës shkresë të shoqërisë “Sh.” sh.p.k., konstatohet se shuma e mbetur si detyrim nga porositësi ndaj shoqërisë është vlera 19,650 euro, që korrespondon me 10 % të vlerës që do të paguhet si këst i fundit deri në hipotekimin e apartamentit. Sipas shoqërisë “Sh.” sh.p.k., nga shuma e përgjithshme prej 196,500 eurosh janë zbritur nga vlera totale e apartamentit 6,083 euro për punime të kryera nga porositësi. Pra, çmimi i rishikuar i apartamentit është tashmë në shumën prej 190.417 eurosh.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të muajit janar 2019, si dokumentacion ligjor justifikues për pagesat që ka kryer te shoqëria “Sh.” sh.p.k., ka depozituar 17 mandatpagesa të lëshuara nga kjo shoqëri, në monedhën euro për një vlerë totale prej 63,000 eurosh dhe 5 mandate në monedhën lekë për një vlerë prej 6,200,000 lekësh (ose të konvertuar në 49.167 euro), si dhe 60,000 euro të paguara nga kredia e marrë nga “Alpha Bank”. Sipas subjektit, gjithashtu, nga shuma e përgjithshme prej 196,500 eurosh është zbritur dhe vlera 6,083 euro për shkak të punimeve të pabëra nga ana e firmës.

3.13. Subjekti shpjegon se, nga shuma prej 6,083 eurosh, është ulur si pasojë e punimeve të pakryera nga shoqëria “Sh.” sh.p.k., punime të cilat janë bërë vetë gjatë periudhës 2010 deri 2016, vit në të cilin subjekti ka filluar të jetojë aty. Të gjitha këto shpenzime janë bërë në hapësira kohe relativisht të gjata të shkëputura nga njëra-tjetra, dhe për pasojë, subjekti deklaroi se, nuk disponojnë fatura të punimeve përkatëse.

3.14. Nga shuma totale prej 190.417 eurosh, tashmë kanë mbetur si detyrim i papaguar 10 % e çmimit total, në vlerën 19,650 euro, vlerë e cila do të shlyhet pasi të bëhet hipotekimi i apartamentit.

3.15. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

3.16. Në lidhje me këstin e parë, ka mospërputhje në lidhje me kohën dhe aktin mbi të cilin është paguar shuma prej 6.200.000 lekësh ose 49.000 euro, duke krahasuar deklaratën “Vetting” të vitit 2017 me informacionin e dërguar nga shoqëria “Sh.” sh.p.k., dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të janarit të vitit 2019, për shkak se në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti deklaroi se e ka paguar këstin e parë prej 49.000 eurosh në momentin e firmosjes së kontratës së sipërmarrjes, e cila daton më 14.02.2009, ndërkohë që, në informacionin e ardhur me shkresë nga shoqëria “Sh.” sh.p.k., dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të janarit të vitit 2019, konstatohet se, subjekti e ka shlyer shumën prej 6.200.000 lekësh ose e konvertuar në euro 49.000 euro, para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

3.17. Pra, subjekti i rivlerësimit ka kryer tri pagesa nga viti 2008 dhe dy pagesa në vitin 2009, por të gjitha para datës së firmosjes së kontratës.

3.18. Lidhur me pagesën e këstit të dytë, përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar.

3.19. Në lidhje me pagesën e këstit të tretë, subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje me kohën e pagesës, vlerën e pagesës, numrin e mandateve si dhe pasaktësi në shumatoren e mandateve të dërguara, midis dokumenteve të dërguara nga shoqëria “Sh.” sh.p.k., dhe ato që ka dërguar subjekti i rivlerësimit për shkak se:

- i. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se ka paguar këstin e III-të në vitin 2014, në shumë 60.000 euro, pa përcaktuar kohën se kur, vlerën apo faktin nëse janë paguar me këste apo jo.

- ii. Ndërkohë që, në informacionin e dërguar nga shoqëria “Sh.” sh.p.k., dhe përgjigjet e pyetësorit rezulton se mandatet janë paguar të gjitha në vitin 2015 dhe jo në vitin 2014 siç deklaroi subjekti.
 - iii. Ndërkohë që, nga shuma e mandateve të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të janarit 2019, subjekti deklaroi se pagesa e kryer për këstin e III-të është 63.000 euro.
- 3.20.** Ndërkohë që, po të bësh shumatoren e mandateve të dërguara nga subjekti, vlera është 58.500 euro dhe jo 63.000 euro siç deklaroi subjekti.
- 3.21.** Në lidhje me shumën prej 6,083 eurosh, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur amendimin/ndryshimin e kontratës së sipërmarrjes, për disa punime të pakryera nga sipërmarrësi dhe që janë kryer nga vetë subjekti. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit për këtë shumë nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor që vërtetojnë llojin, kohën dhe pagesën e kryer.
- 3.22.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, detyrimin e mbetur kundrejt shoqërisë “Sh.” sh.p.k., në shumë 19,650 euro, shumë e cila përfaqëson 10 % të çmimit total të apartamentit (duke qenë se çmimi i kontratës ka ndryshuar nga vlera 196,500 euro në 190,417 euro sipas deklarimeve në pyetësor).
- 3.23.** Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave nga burime të ligjshme për të kryer pagesat e kështit të I-rë dhe të III-të, duke u bazuar në deklarinimin e bërë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.
- 3.24.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, pagesat e kryera sipas mandateve të paraqitura nga shoqëria “Sh.” sh.p.k., si dhe ai vetë .
- 3.25.** Mungon dokumentacioni ligjor justifikues për shumë prej 22,459 eurosh që shoqëria thotë se nuk disponon mandate.

Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni, arsyeton se:

3.26. Subjekti i rivlerësimit kërkoi që, Komisioni, të verifikonte me firmën e ndërtimit se përse data në mandatpagesa është vendosur në vitin 2008, pasi ato nuk i kishin vënë shumë rëndësi.

Komisioni, çmon se, në bazë të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, duhet të kishte verifikuar dhe provuar vetë të kundërtën e rezultateve të hetimit, të cilat kishin dalë nga administrimi i dokumentacionit nga shoqëria e ndërtimit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk provoi dot me dokumentacion se këto pagesa nuk ishin kryer në vitin 2008.

Sipas nenit 52, pika 2 dhe 3, e ligjit nr. 84/2016 (2.) “Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”. (3.) Parashikimet e nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative nuk zbatohen.

3.27. Në lidhje me pretendimin e subjekti të rivlerësimit se, shuma për pagimin e kështit të tretë në shumën prej 60,000 eurosh ka ardhur nga tërheqja e shumës prej 22,000 GBP nga “Raiffeisen Bank” e konvertuar në atë periudhë me 179 lekë = 4,000,000 /lekë, nga kursimet familjare të vitit 2014 që kanë qenë 2,500,000 lekë, të cilat po të mblidhen në total janë në shumën 6,500.000 lekë. Shumë e cila është përdorur për pagimin e kështit të III-të për blerjen e apartamentit. Në vitin 2013 kemi deklaruar shitjen e apartamentit në vlerën 5,349,143 lekë, vlerë e cila bashkë me kursimet e vitit shkon përafërsisht 6,000,000 lekë, kjo pjesërisht u konvertua në 33.000 GBP, të cilat në vitin 2014 u depozituan pranë “Raiffeisen Bank” dhe më pas u tërhoqën (siç është shpjeguar dhe në pyetjen në lidhje me shkollimin e vajzës në Angli). Më pas, vlera prej 11,000 GBP u përdor për shkollimin e vajzës dhe vlera prej 2.000 GBP u konvertua në lekë dhe u përdor për pagesën e kështit të tretë së bashku me pjesën tjetër të kursimeve.

Komisioni pas analizës financiare të vitit 2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura nga burime të ligjshme me dokumentacion justifikues, për të shlyer shumën prej 58,000 eurosh për pagimin e këstit të tretë.

3.28. Në lidhje me kërkesën e subjektit për të vënë në dispozicion përgjigjen nga firma “Sh.” sh.p.k., për mandatet të cilat nuk i posedon subjekti, por për të cilat dhe shoqëria nuk ka sjellë informacion.

Komisioni çmon se, në bazë të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte të gjithë mundësinë sipas ligjit dhe njoftimit të dërguar nga ana e Komisionit për të shikuar të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Por ai nuk u paraqit pranë Komisionit për të marrë kopje dhe shqyrtuar dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

3.29. Si konkluzion, për këtë aset, subjekti i rivlerësimit, ka fshehur vlerën e pasurisë (apartament + garazh), të porositur me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “Sh.” sh.p.k., nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, si në deklaratën e pasurisë “Vetting”, ashtu edhe në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së.

3.30. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur vlerën reale të detyrimit që i ka mbetur shoqërisë. Detyrimi i mbetur, referuar pagesave të deklaruara nga subjekti rezulton në vlerën 27,000 euro, ndërsa sipas deklarimeve ndër vite dhe deklarimit nga ana e shoqërisë rezulton rreth 19,000 euro. Në lidhje me pagesat e kryera ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga ana e subjektit.

3.31. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me likuidimet ndaj shoqërisë “Sh.” sh.p.k, për blerjen e apartamentit dhe garazhit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë shoqëria “Sh.” sh.p.k., pagesa e parë me këtë shoqëri është bërë në vitin 2008 në shumën prej 3,700,000 lekësh, ndërsa është deklaruar nga subjekti si pagesë e bërë në vitin 2009.

3.32. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në vitin 2008 për pagesën e shumës 3,700,000 lekë ose rreth 30,000 euro.

4. Në lidhje me pasurinë, tokë ullishte, me sip. 3000 m², ndodhur në Sh., Durrës dhe sip. 2775 m², po në Sh., Durrës.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Shkresën nr. (***)prot., datë 16.02.2018, administruar nga ZVRPP-ja Durrës, informacionin në lidhje me pasuritë e paluajtshme të z. Petrit Çeno dhe familjarëve të tij, por nuk konfirmon dy pasuritë e mësipërme të paluajtshme të znj. M. Ç. edhe nëse ato do të ishin të transkriptuara;
- ✓ Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

4.1. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar një sipërfaqe toke, ullishte, me sip. 3000 m², me nr. pasurie (***), ZK (***), ndodhur në Sh., Durrës.

4.2. Si burim krijimi është deklaruar përfitimi sipas ligjit nr. 7501 “ Për tokën”, datë 19.07.1991, si ish-punonjëse e Ndërmarrjes Bujqësore Frutore, Durrës. Pjesa takuese: 100 %.

4.3. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën “Vetting”, për të mbështetur deklaratimet e tij ka depozituar:

- i. Certifikatën e pronësisë, datë 31.10.2001, për pasurinë ullishte, ndodhur në Sh., me sip. 3000 m², ZK (***), vol. 12, në emër të znj. M.Ll.;
- ii. Hartën treguese të pronës;
- iii. AMTP-në me nr. (***) akti, datë 02.02.1999, rrethi Durrës, fshati - nuk është shënuar, i jepet në pronësi familjes së znj. M. Ç. (Ll.), gjithsej **3000 m², ullishte**;
- iv. Certifikatën e pronësisë, datë 21.03.2002, për pasurinë ullishte, ndodhur në Sh., me sip. 2775 m², ZK. (***), vol. (***), fq. (***), në emër të znj. M. Ll.;
- v. Hartën treguese të pronës;
- vi. AMTP-në me nr. (***), datë 22.09.1999, rrethi Durrës, fshati - nuk lexohet, i jepet në pronësi familjes së znj. M. Ç. (Ll.) gjithsej - nuk është shënuar, 2.750 m² ullishte dhe 600 m² ullishte = 3350 m² ullishte.

4.4. Komisioni ka hetuar origjinën e kësaj prone dhe ZVRPP-ja Durrës me shkresën nr. (**) prot., datë 03.08.2018, ka dërguar informacionin dhe dokumentacionin me anë të të cilit vërteton se, në emër të znj. M. Ç. (Ll.) nga verifikimi në sistemin e ZVRPP-së Durrës, rezultoi se janë regjistruar:

1. Pasuri me nr. (***) lloji i pasurisë, ullishte, adresa Sh., referuar aktit (***) me sipërfaqe totale të pasurisë 3375 m² sipas librit të ngastrave, me datë regjistrimi 12.03.1999.
2. Pasuri me nr. (***) lloji i pasurisë, ullishte, adresa Sh., referuar aktit (***) me sipërfaqe totale të pasurisë 3000 m² sipas librit të ngastrave, me datë regjistrimi 03.02.2000.
3. Ndërkohë, akti (***) ose AMTP-ja nr. (***) akti, mbi të cilat referohen të dy kartelat e pasurive me sip. 3000 m² dhe sip. 3775 m², mban datën 09.09.1993 dhe është në emër të z. B. M., nga fshati Sh., ku i jepet në pronësi tokë gjithsej 3200 m², me përshkrim:
 - (***)tek shtëpia, gjithsej sip. 1700 m² tokë arë;
 - (***)tek shtëpia, gjithsej sip. 1300 m², nga të cilat 500 m² tokë arë, 700 m² pemëtore dhe 100 m² truall;
 - (***)stani deleve, gjithsej 200 m² ullishte.
4. Kartelë e pasurisë së paluajtshme “ullishte” me sip. **3000 m²**, nr. pasurie (***) , vol. (***) , fq. (***) , ZK (***) , nr(***) akti, datë regjistrimi 03.02.2000.
5. Kartelë e pasurisë së paluajtshme “ullishte” me sip. **3350 m²** dhe **3375 m²**, nr. pasurie (***) , vol. (***) , fq. (***) , znj. M. L., akti (***) , datë regjistrimi 12.03.1999 (mbyllur).

4.5. Subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se me shtetasin B. M., i cili figuron përfaqësuesi i familjes bujqësore për AMTP-në, nr. (***) akti, dokument mbi të cilin bazohen kartelat e pasurisë së znj. M. Ll. (Ç.), nuk asnjë lidhje ai personalisht apo familjarët e tij.

4.6. Duke marrë shkak nga kjo mospërputhje, Komisioni i kërkoi subjektit dokumentacionin i cili vërteton se bashkëshortja e subjektit e ka qenë pjesë e ish-Ndërmarrjes Bujqësore Frutore Durrës.

4.7. Për të vërtetuar sa më lart, subjekti ka paraqitur librezën e punës të znj. M. Ç., e cila specifikon se ajo ka filluar punë, më datë 01.04.1989, në ish-Ndërmarrjen Frutore Durrës deri më datë 31.08.1993 si dhe Akt Vlerësimin e Punës nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës.

4.8. Në lidhje me konstatimin fillestar për tokën ullishte dhe dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Durrës, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se pranë ZVRPP-së ka depozituar vetëm dy AMTP: (i) nr. (***) , datë 22.09.1995, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, në mbështetje të ligjit 7501, datë 19.07.1991, parcela nr. (***) , me sip. 2750 m² dhe 33 rrënjë ullinj dhe parcela nr. (***) , me sip. 600 m² dhe 8 rrënjë ullinj. Aktualisht kjo pasuri i është vënë në dispozicion shoqërisë “Ll.” sh.p.k., për ndërtim. (ii) parcela nr. (***) , me sip. 3000 m² dhe 15 rrënjë ullinj.

4.9. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

4.10. Ka mospërputhje midis dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti për mënyrën e fitimit të pronësisë ullishte, me sip. 3000 m² dhe sip. 2775 m², me dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Durrës në lidhje me të dhënat që i përkasin AMTP-ve, pasi:

- ✓ numri i AMTP-ve të depozituara nga subjekti janë (i) AMTP-ja me nr. (***) akti, datë 02.02.1999; dhe (ii) AMTP-ja me nr. (***) akti, datë 22.09.1999;
- ✓ ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Durrës, këto pasuri i janë referuar një AMTP-je tjetër me nr. (***) akti dhe lëshuar më datë 09.09.1993;
- ✓ sipërfaqja e pronës së fituar në total është 6375 m² nga bashkëshortja juaj, ndërkohë që AMTP nr. (***) akti, ka sipërfaqe të përgjithshme 3200 m².

4.11. Ka mospërputhje në lidhje me deklarin e vendbanimit në deklaratën e vlerësimit të pasurisë, pasi sipas dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Durrës, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit figuron si përfaqësuese e familjes bujqësore për pasuritë me nr. (***) si dhe me nr. (***), ndërkohë që nga deklarinet e subjektit për procesin e rivlerësimit ai deklaron se ka qenë banor gjatë gjithë kohës në qytetin e Durrësit.

Lidhur me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, Komisioni, arsyeton se:

4.12. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ti vënë në dispozicion AMPT-në nr. (***) akti, që është administrua nga hetimi, Komisioni, arsyeton se, *në bazë të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i është vënë në dispozicion e gjithë dosja me dokumentet e administruara gjatë hetimit.*

4.13. **Si konkluzion**, për këtë aset, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk provoi me anë të shpjegimeve apo dokumenteve mospërputhjet që ekzistonin midis deklarinimit të tij dhe dokumentacionit të administruar në dosje, për mënyrën e fitimit të pronësisë së këtij aseti.

5. Në lidhje me pasuritë e paluajtshme, apartamente + garazhe, ndërtuar mbi pronën ullishte, me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. (*) datë 14.11.2009, me shoqërinë “Li.” sh.p.k., nga ku znj. M. Ç. përfiton 23 % të ndërtimit.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Shkresën nr. (***) prot., datë 16.02.2018, administruar nga ZVRPP-ja Durrës, informacionin në lidhje me pasuritë e paluajtshme të z. Petrit Çeno dhe familjarëve të tij;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës;
- ✓ Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

5.1. Në deklaratën “Vetting” personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar, këto pasuri nëpërmjet kontratës së shkëmbimit nr. (***) datë 12.12.2011, dhe konkretisht:

1. Garazh G8, me sip. **77 m²**, nr. pasurie (***) , vol. (***) , fq. (***) ;
2. Njësi (dyqan) nr. 4, me sip. **68 m²**, nr. pasurie (***) , vol. (***) , fq. (***) ;
3. Apartament, me sip. **98.02 m²**, nr. pasurie (***) , ZK (***) , vol. (***) , fq. (***) , ndodhur në Sh., Durrës;
4. Apartament, me sip. **111.56 m²**, nr. pasurie (***) , ZK (***) , vol. (***) , fq. (***) , ndodhur në Sh., Durrës;

5. Apartament, me sip. **96.16 m²**, nr. pasurie (***), ZK (***), vol. (***), fq. (***), ndodhur në Sh., Durrës;
6. Apartament, me sip. **98.02 m²**, nr. pasurie (***), ZK (***), vol. (***), fq. (***), ndodhur në Sh., Durrës;
7. Apartament, me sip. **103.31 m²**, nr. pasurie (***), ZK (***), vol. (***), fq. (***), ndodhur në Sh., Durrës;
8. Apartament, me sip. **63.95 m²**, nr. pasurie (***), ZK (***), vol. (***), fq. (***), ndodhur në Sh., Durrës.

5.2. Si burim krijimi është deklaruar kontrata e shkëmbimit, nr. (***), datë 12.12.2011.

5.3. ZVRPP-ja Durrës me shkresën nr. (*) prot., datë 16.02.2018, drejtuar Komisionit** ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës:

1. Kontrata e shkëmbimit të pasurive të paluajtshme, nr. (***), datë 12.12.2011, me palë shkëmbyese M. Ç., pronare e vetme e tokës, me sip. 2775 m², nr. pasurie (***), dhe firma ndërtimore “Ll.” sh.p.k., në Durrës, për përfitimin e apartamenteve, njësave të shërbimit dhe garazhit të lartpërmendura.
2. Kontratë shitblerjeje, nr. (***), datë 30.06.2016, përpara noterës E.N., në Durrës, me shitës M.+Petrit Çeno dhe blerës R. T., shtetas italian, për shitjen e apartamentit, me sip. 63.95 m², nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), nr. (***), ZK (***), në Sh., Durrës. Çmimi i shitjes në vlerën 25,000 euro, likuiduar nga blerësi të shitësi në llogarinë e noterës.
3. Kontratë shitblerjeje, nr. (***), datë 12.02.2013, përpara noterës M. Rr., në Durrës, me shitës M. Ç. dhe blerës R. Ç., për apartamentin me sip. 103.31 m², ap. (***), me nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), nr. (***), ZK (***), në Sh., Durrës. Çmimi i shitjes në vlerën 5,349,143 lekë, duke deklaruar se çmimi është paguar “jashtë zyrës noteriale”.

5.4. Më datë 21.01.2009, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje, nr. (***), datë 21.01.2009, me shoqërinë “Ll.” sh.p.k., për ndërtimin e një godine banimi shumëkatëshe, ku bashkëshortja e subjektit përfiton me shkëmbim .23 % të pjesës takuese mbi ndërtesën, truallin dhe shtesën e katit. Më tej, më datë 14.11.2009, palët firmosin një aneks kontratë nr. (***), datë 14.11.2009, ku përcaktohet se personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit do të përfitojë: (i) pesë apartamente banimi; (ii) apartament banimi, me sipërfaqe 150 m² + tarracë të shfrytëzueshme me sip. 150 m²- ndodhur në katin papafingo. Si përfundim, më datë 12.12.2011, palët kanë nënshkruar një kontratë shkëmbimi, nr. (***), datë 12.12.2011, me palë shkëmbyese M. Ç. si pronare e tokës me sip. 2775 m², dhe palë shkëmbyese shoqëria “Ll.” sh.p.k.

5.5. Ndërkohë që shoqëria “Ll.” sh.p.k., në vitin 2008 ka pasur një proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin nr. (***), datë 01.04.2008, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesë padisë së palës paditëse shoqëria “Ll.” sh.p.k., me qendër në Durrës, me objekt anulimin e aktit administrativ “njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. (***), datë 29.12.2005, të nxjerrë nga pala e paditur”*. Ky vendim është ankimuar nga ana e paditësit, shoqërisë “Ll.” sh.p.k., pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

5.6. Në vitin 2011, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. (***), datë 24.01.2011, me trup gjykues të përberë nga kryesues gjyqtar K. S., anëtar gjyqtar A. F. si dhe gjyqtar Petrit Çeno, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit civil nr. (***), datë 01.04.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës si më poshtë: Pranimin e kërkesës së paditësit shoqëria “Ll.” sh.p.k., për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë ankim gjyqësor kundër aktit administrativ nr. (***), datë 29.12.2005, të nxjerrë nga Dega e Tatim Taksave Durrës; Pranimin e padisë të paditësit, shoqëria “Ll.” sh.p.k., Shfuqizimin e aktit administrativ nr. (***), datë 29.12.2005, “Njoftim vlerësimi për detyrimet” të nxjerrë nga DTT-ja Durrës.”*

5.7. Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

5.8. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar përjashtimin nga trupi gjykues si dhe nuk ka deklaruar pranë ILDKPKI-së konfliktin e interesit me shoqërinë “Ll.” sh.p.k.

5.9. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar tarracën e shfrytëzueshme me sip. 158.1 m² mbi të cilën është apartamenti nr. (***) , me sip. 111,56 m², kati i VIII, që është kati papafingo (me certifikatë pronësie), e cila pasqyrohet tek kontrata e shkëmbimit nr. (***) , datë 12.12.2011, në fq. 7 të saj, si në deklaratën periodike të vitit 2011 ashtu edhe në deklaratën “Vetting”.

5.10. **Si konkluzion**, në lidhje me këto asete të deklaruara, subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me firmën e ndërtimit “Ll.” sh.p.k., në kohën kur ka qenë anëtar i trupit gjykues që i ka dhënë të drejtën firmës ndërtimit duke i pranuar padinë.

5.11. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur tarracën e shfrytëzueshme me sip. 158.1 m² , në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, si dhe në deklaratën e interesave vjetore private të vitit 2011.

6. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, apartament, me sip. 91.51 m², në Golem, Kavajë

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit administroi nga institucionet:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Deklarimet në deklaratat e interesave vjetore periodike, për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012;
- ✓ Shkresën me nr. (***) prot., datë 12.02.2018, administruar nga ZVRPP-ja Kavajë,¹⁶ informacionin në lidhje me pasuritë e paluajtshme të z. Petrit Çeno dhe familjarëve të tij;
- ✓ ALUIZNI me shkresën nr. (***) prot., datë 01.08.2018, drejtuar Komisionit, ka dërguar dosjen e praktikës së legalizimit në emër të znj. M. Ç.;
- ✓ Deklarimet dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në përgjigje të pyetjeve të Komisionit;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

6.1 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklararon se, nëpërmjet aktmarrëveshjes, datë 06.06.2007, lidhur ndërmjet shoqërisë “E.” sh.p.k, si sipërmarrësi dhe znj. M. Ç. si porositëse është blerë një apartament ndërtuar mbi truallin e parcelës bregdetare (***) , në Golem, në vlerën 55,000 euro. Bashkëlidhur deklaramit subjekti ka dërguar dokumentacion justifikues.¹⁷

6.2 Kjo pronë është shitur me kontratën nr. (***) , datë 18.11.2014, me palë shitëse M. Ç. dhe palë blerëse E. dhe K. K., në vlerën 95,000 euro.

¹⁶ZVRPP-ja Kavajë me shkresën nr. (***)prot., datë 12.02.2018, drejtuar Komisionit ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar dhe konkretisht: (i) Leje legalizimi nr. (***) , datë 18.04.2012, në emër të M. Ç., Q. H. etj... për legalizimin e objektit “godinë banimi 3 kate” në ZK (***) , sipërfaqja e parcelës ndërtimore 627.3 m², sipërfaqe e ndërtimit 169.6 m², sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 471.5 m².; (ii) Bashkangjitur dhe genplani i sipërfaqes së banimit 81.6 m² në emër të M.a Çeno. (iii)Kontratë shitjeje nr. (***) , datë 31.01.2012, lidhur përpara notere M. Sh., me shitës ALUIZNI dhe blerës M.Ç., me objekt kalimin në pronësi nga shitësi tek blerësi të pasurisë së paluajtshme truall me sipërfaqe truall të njësisë prej 627.3 m² në bashkëpronësi nga ku znj. M. Ç., përveç pjesës së bashkëpronësisë kalon në pronësi të vetë , sipërfaqja e oborrit prej 70.69 m² sipas planimetrisë dhe formularit të pagesës bashkangjitur kontratës sipërfaqja e bazës të njësisë 169.6 m² dhe sipërfaqja e banimit 81.6 m². Blerësi ka paguar çmimin 158,412 lekë. Më pas kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së Kavajë, më datë 11.06.2012.

¹⁷ Aktmarrëveshje, datë 06.06.2007, ndërmjet znj. M. Ç. dhe shoqërisë “E.” sh.p.k., për apartament me nr. (***) dhe sip. 91.51 m², me oborr me sip. 61 m², si dhe vend parkimi nr. (***) me sip. 12.5 m², në Golem, Kavajë, me çmim të përbashkët 55.000 euro. Shuma 30.000 euro është paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës kurse shuma 25.000 euro do paguhet më vonë. Kontratë shitblerjeje nr. (***) , datë 18.11.2014, për shitjen nga znj. M. Ç., të apartament me sip. 81.6 m² dhe truall me sip. 157.53 m², në K., me vlerën prej 95.000 eurosh.

6.3 Si burim krijimi për blerjen e apartamentit të vitin 2007, për pagesën që ka kryer në vlerën prej 30,000 eurosh, subjekti nuk e ka deklaruar.

6.4 Më tej, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se e ka shitur me anë të kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 18.11.2014, me blerës E. dhe K. K. për apartamentin me sip. 81.6 m², në shumën 95,000 euro, duke deklaruar se ky çmim është xhirua në llogari të noteres për llogari të shitësit pranë “Intesa Sanpaolo Bank” Kavajë.

6.5 ZVRPP-ja Kavajë me shkresën nr. (***) prot., datë 12.02.2018, drejtuar Komisionit ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar dhe konkretisht:

- i. Leje legalizimi nr. (***) , datë 18.04.2012, në emër të znj. M. Ç. dhe z. Q. H. etj... për legalizimin e objektit “godinë banimi 3 kate” në ZK (***) , sipërfaqja e parcelës ndërtimore 627.3 m², sipërfaqe e ndërtimit 169.6 m², sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 471.5 m².
- ii. Bashkangjitur dhe genplani i sipërfaqes së banimit 81.6 m² në emër të znj. M. Ç. .
- iii. Kontratë shitjeje nr. (***) , datë 31.01.2012, lidhur përpara noteres M. Sh. me shitës ALUIZNI dhe blerës M. Ç., me objekt kalimin në pronësi nga shitësi tek blerësi të pasurisë së paluajtshme, truall, me sipërfaqe trualli të njësisë me sip. 627.3 m² në bashkëpronësi nga ku znj. M. Ç., përveç pjesës së bashkëpronësisë kalon në pronësi të vetë, sipërfaqja e oborrit prej 70.69 m² sipas planimetrisë dhe formularit të pagesës bashkangjitur kontratës, sipërfaqja e bazës së njësisë 169.6 m² dhe sipërfaqja e banimit 81.6 m². Blerësi ka paguar çmimin 158,412 lekë. Më pas kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së Kavajë, më datë 11.06.2012.

6.6 Referuar aktmarrëveshjes, datë 06.06.2007¹⁸, palë e kësaj janë sipërmarrësi, shoqëria “E.” sh.p.k., përfaqësuar nga z. P. C. dhe në cilësinë e porositësit M. Ç., me objekt, ndërtimin e apartamentit nr. (***) , të vilës së përbashkët nr. (***) , blloku (***) , me sipërfaqe aktuale ndërtimi 84.26 m² dhe sipërfaqe aktuale totale 91.51 m², ndodhur në katin përdhe me oborr, me sip. 61 m² dhe vend parkimi nr. 38 me sip. 12.5 m², ndodhur në oborrin e përbashkët pranë vilës.

6.7 Sipas së njëjtës aktmarrëveshje, çmimi për njësinë nr. 38, me sipërfaqe aktuale 91.51 m² përfshi oborrin e brendshëm me sip. 61 m² në dispozicion të këtij apartamenti si dhe për vendparkimin nr. 38, çmimi do të jetë 55,000 euro. Në nenin 3 të kësaj aktmarrëveshjeje përcaktohet mënyra e pagesës si vijon:

- i. Kësti i I - shuma prej 30,000 eurosh është paguar në momentin e nënshkrimit të kësaj aktmarrëveshjeje.
- ii. Kësti i II - diferenca prej 25,000 eurosh do të paguhet nga porositësi në një periudhë të mëvonshme bashkërisht.
- iii. Pagimin prej 100 USD në vit për çdo njësi si qira trualli, pas marrjes në dorëzim.

6.8 ALUIZNI me shkresën nr. (***) prot., datë 01.08.2018, drejtuar Komisionit ka dërguar dosjen e praktikës së legalizimit në emër të znj. M. Ç., leje legalizimi nr. (***) , datë 18.04.2012, në emër të znj. M. Ç. dhe z. Q. H. etj... për legalizimin e objektit “godinë banimi 3 kate”, në ZK (***) , sipërfaqja e parcelës ndërtimore 627.3 m², sipërfaqe e ndërtimit 169.6 m², sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 471.5 m².

6.9 Në lidhje me pagesën e këstit të dytë prej 25.000 eurosh, subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se ky këst është paguar, më datë 19.12.2011, në vlerën 15.000 euro, vërtetuar me një vërtetim të lëshuar nga ana e shoqërisë

6.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

6.11 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave private të viteve 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, në lidhje me apartament dhe vendparkim, në Golem, Kavajë, i cili referuar aktmarrëveshjes së paraqitur është prenotuar dhe paguar kësti prej 30.000 eurosh në

¹⁸ Aktmarrëveshja e datës 06.06.2007 ndodhet në dosje e depozituar nga vetë subjekti

vitin 2007, dhe jo në vitin 2011, fakt që dhe vetë subjekti i rivlerësimit e pranoi gjatë shpjegimeve të tij.

6.12 Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi dhe provoi mospërputhjet në lidhje me kohën kur është paguar kësti në vlerën prej 30,000 eurosh. Këto mospërputhje konsistojnë në: (i) Në aktmarrëveshjen, datë 06.06.2007, është rënë dakord se kësti i I-rë, shuma prej 30,000 eurosh është paguar para momentit të nënshkrimit të kësaj aktmarrëveshje; (ii) Ndërkohë që në vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “E.” sh.p.k., më datë 15.01.2019, konstatohet se kjo shumë është paguar, më datë 08.06.2007, pra 2 ditë më vonë se firmosja e kontratës; (iii) Ndërkohë që subjekti nuk deklaroi këtë detyrim të shlyer në vitin 2007, sipas deklaratës së vitit 2007; (iv) Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2011 deklaroi se e ka paguar këtë detyrim në shumën prej 30,000 eurosh ndaj shoqërisë “E.” sh.p.k., në vitin 2011 nga pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në vitet 2008, 2009 dhe 2010.

6.13 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me mospërputhjet që ekzistojnë në lidhje me kohën kur është paguar kësti prej 2,000 eurosh, për shkak se: (i) Në deklaratën e vitit 2011, subjekti deklaroi detyrim të mbetur ndaj firmës “E.” sh.p.k., në shumën 25,000 euro; (ii) Ndërkohë që në DVP 2012, subjekti deklaroi se ka shlyer shumën 15,000 euro dhe ka detyrim të mbetur shumën prej 10,000 eurosh; (iii) Ndërkohë që në DVP 2013 subjekti nuk e deklaroi si detyrim. (iv) Ndërkohë që në vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “E.” sh.p.k., më datë 15.01.2019, rezultoi se nga kjo shumë është paguar 15,000 euro, më datë 19.12.2011, dhe shuma e mbetur prej 10,000 eurosh është paguar, më datë 12.12.2014.

6.14 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012, kontratën “Shitje për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit”, me shitës ALUIZNI dhe blerës M. Ç., për kalimin e truallit dhe ndërtimit në pronësi të znj. M. Ç., ku ka paguar dhe shumën prej 158,412 lekësh, vlerë e parcelës ndërtimore, vlerë kjo e padeklaruar.

6.15 Në lidhje me mospërputhjet e sipërfaqes së objektit midis aktmarrëveshjes së datës 06.06.2007, ku është porositur apartamenti (***) i vilës së përbashkët me sipërfaqe aktuale ndërtimi 84.26 m² dhe sipërfaqe aktuale 91.51 m², ndodhur në katin përdhe, me oborr, me sip. 61 m², ndërkohë që në kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 18.11.2014, është specifikuar se është shitur pasuri i llojit apartament me sipërfaqe totale 81.6 m² dhe kuotë pjesëmarrje 25.1 %, truall i shprehur në m² 157.53 m², subjekti i rivlerësimit shpjegoi se diferenca prej 10 m² është ajo e ambienteve të përbashkëta të cilat nuk regjistrohen.

6.16 **Si konkluzion** në lidhje me këtë aset, subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe ka kryer deklaram të rremë në deklaratat e interesave private të viteve 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, në lidhje me apartament dhe vendparkim në Golem, Kavajë.

6.17 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e interesave privat të vitit 2012, blerjen dhe kalimin e pronësisë së truallit të pronës në Golem, Kavajë.

6.18 Subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me dokumentacion ligjor justifikues se kur janë paguar ekzaktësisht këstet e këtij apartamenti.

6.19 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën periodike të vitit 2012, kontratën “Shitje për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit”, me shitës ALUIZNI dhe blerës M. Ç., për kalimin e truallit dhe ndërtimit në pronësi të znj. M. Ç., ku ka paguar dhe shumën prej 158,412 lekësh, vlerë e parcelës ndërtimore, vlerë kjo e padeklaruar.

6.20 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistojnë mbi sipërfaqen e ndërtimit në aktmarrëveshjen, datë 06.06.2007, të porosisë dhe kontratës së shitjes në vitin 2014.

7. Kredia në shumën prej 80,000 eurosh, marrë nga banka “Societe Generale Albania”.

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi nga institucionet dhe jo vetëm:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Deklaratën e interesave privatë, vjetore të vitit 2012, dhe 2013;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga “Societe Generale Albania”;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga QKB-ja me shkresën nr. (***) prot., datë 10.04.2018, drejtuar Komisionit;
- ✓ Shkresën e administruar nga shoqëria “B. M. I.” sh.p.k., (ish-shoqëria “H. I.” sh.p.k), dërguar ILDKPKI-së;¹⁹
- ✓ Dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria që konfirmon kalimin e shumës së disbursuar të kredisë në favor të shoqërisë “H. I.” sh.p.k (fillimisht nga “Societe Generale Albania” tek shoqëria “Ll.” sh.p.k., dhe nga “Ll.” sh.p.k., te shoqëria “H. I.” sh.p.k);
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

7.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi lidhur/djali i subjekti, deklaroi se, për llogari të shoqërisë “H. I.” sh.p.k., është financuar me një kredi në shumën 80,000 euro nga “Societe Generale Albania”, për të cilën janë vënë kolateral pasuritë e Petrit dhe M. Ç., në Sh., Durrës. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka dërguar dokumentacion justifikues.²⁰

7.2 Në DPV të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë kredi te “Societe Generale Albania”, për strehim, më datë 14.12.2012, në vlerën 80,000 euro. Pagesa e kësaj të parë fillon në janar 2013.

7.3 Në DPV të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga kredia te “Societe Generale Albania”, në vlerën 80,000 euro, ka shlyer vlerën 7,000 euro.

7.4 Në DPV të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi më detyrime nga kredia te “Societe Generale Albania”, në vlerën 80,000 euro, por këtë detyrim ja transferon shoqërisë “H. I.”. Personi i lidhur/djali i subjektit, në DPV 2014, në pozicionin e aksionerit me 33.0 % të kuotave të shoqërisë, deklaroi se shlyerja e kësaj kredie do ti bëhet nga kjo kompani si pjesë e biznesit të saj.

7.5 Në DPV të vitit 2015, personi i lidhur/djali i subjektit, nuk deklaroi asnjë të ardhur si aksioner me 33.0 % të kuotave të shoqërisë “H. I.” sh.p.k., por deklaroi vetëm të ardhura nga paga dhe shpërblime si administrator.

7.6 Në dokumentacionin e depozituar nga banka, konstatohet se llogaria e kredisë është 3 emërore (d.m.th detyrimi paguhet nga një llogari që rezulton në emër të Pertit Çenos, M. Ç.

¹⁹ Shkresën e protokolluar me nr. (***) prot., datë 22.12.2017, bën me dije se shuma prej 79,734 eurosh ka kaluar në favor të kësaj shoqërie, më datë 28.12.2012, në “Raiffeisen Bank”, si pasojë e revokimit të kontratës së blerjes së një apartamenti me “Ll.” sh.p.k., Durrës (revokim kontrate nr. (***)), me anë të një kredie personale, tërhequr nga ortaku E. Ç., pranë “Societe Generale Albania”. Kjo shumë është përdorur për kapital qarkullues nga shoqëria.

²⁰ Konfirmim bankar nr. (***) datë 01.11.2016, “Societe Generale Albania”, Dega Vip, sipas të cilit E. Ç., Petrit Çeno dhe M. Ç. janë financuar me kredi hipotekore në shumën 80,000 euro, me vlerë të mbetur 71,291 euro.

Kontratë hipotekimi nr. (***) datë 17.12.2012, ku hipotekuese M. Ç. hipotekon në favor të “Societe Generale Albania”, pasuritë në Sh., Durrës, në ZK (***) apartment me sip. 96.16 m², apartament me sip. 111.56 m² dhe njësi me sip. 68 m², për efekt garancie të sigurimit të kredisë së marrë nga E. Ç. .

Certifikatë për vërtetim pronësie nr. (***) për apartament, me sip. 111.56 m², në Sh. dhe kartelë pasurie, sipas së cilës pasuria është rivlerësuar në shumën 5.776.309 lekë, më datë 22.12.2011.

Kartelë pasurie, sipas së cilës pasuria njësi, me sip. 68 m² është rivlerësuar në shumën 5.281.315 lekë, më datë 22.12.2011.

Kartelë pasurie, sipas së cilës pasuria apartament, me sip. 96.19 m² është rivlerësuar në shumën 4.978.934 lekë, më datë 22.12.2011.

Policë e sigurimit të jetës, datë 18.12.2012, nga shoqëria e sigurimit “S.” për E. Ç., afati 20 vjet.

Policë e sigurimit nga zjarri, datë 14.12.2012, nga E. dhe M. Ç. për objektet e siguruara, apartament 96.16 m², apartament me sip. 111.56 m² dhe njësi me sip. 68 m², në ZK (***)

dhe E. Ç.), duke përcaktuar se detyrimi në vitin 2018 i papaguar rezulton në vlerën 67,464 euro.

7.7 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

7.8 Ka mospërputhje në lidhje me kredimarrësin pasi në deklaratën “Vetting” personi i lidhur deklaroi se ky detyrim i ka kaluar shoqërisë “H. I.” sh.p.k., ndërkohë që në dokumentin e ardhur nga “Societe General Albania” me nr. (***) datë 23.03.2018, specifikohet se llogaria e kredisë është 3 emërore (d.m.th detyrimi paguhet nga një llogari që rezulton në emër të Pertit Çenos, M. Ç. dhe E. Ç.), duke përcaktuar se detyrimi në vitin 2018 i papaguar rezulton në vlerën prej 67,464 eurosh. Pra nuk vërtetohet zëvendësimi i kredimarrësit nga Petrit, M. dhe E. Ç. te shoqëria H. I.” sh.p.k.

7.9 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në seksionin detyrime financiare në deklaratën “Vetting” dhe ato vjetore kredinë e marrë pranë “Societe General Albania” në emrin e tij dhe të personit të lidhur/bashkëshortes.

7.10 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor provues për të vërtetuar se kredia ka kaluar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit dhe djali tek shoqëria “H. I.” sh.p.k.

7.11 Si konkluzion, në lidhje me këtë kredi, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten dhe djalin E. Ç., kanë kryer deklaram të rremë ndaj “Societe Generale Albania”, në lidhje me destinacionin e përdorimit të kredisë.

7.12 Ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar likuidimin e kësteve të kredisë nga shoqëria “H. I.” sh.p.k., si përfituese indirekte e kredisë.

7.13 Ka deklarim të rremë të subjektit në deklaratën e vitit 2012 për kredinë e marrë pranë “Societe Generale Albania” për strehim, pasi është fshehur apartamenti që do përfitohej, po ashtu edhe revokimi i kontratës për apartamentin, si dhe kalimi i kredisë në favor të shoqërisë “H. I.” sh.p.k.

7.14 Ka deklarim të rremë në deklaratën e vitit 2013 për shlyerjet e kredisë pranë “Societe Generale Albania”, meqenëse kredia ka kaluar që në vitin 2012 në favor të “H. I.” sh.p.k.

8. Deklarimi i personit të lidhur, djalit të subjektit të rivlerësimit, E. Ç. .

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi nga institucionet dhe jo vetëm:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga QKB-ja me shkresën nr. (***) prot., datë 10.04.2018, drejtuar Komisionit;
- ✓ Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*);
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

8.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit, E. Ç., në deklaratën e personit të lidhur me subjektin, ka deklaruar: I punësuar pranë shoqërisë “H. I.” sh.p.k., në cilësinë e administratorit për periudhën dhjetor 2011 deri më tani. Të ardhura neto të krijuara: në vlerën 5,750,944 lekë. Bashkëaksioner në shoqërinë “H. I.” sh.p.k., me 33%.

8.2 Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar se: Djali E. Ç. është b/pronar në shoqërinë “H. I.” sh.p.k., me leje studimi minerale me kapital fillestar në vlerën 100,000 lekë. Shtesë në vlerën 50,000 lekë.

8.3 Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti ka deklaruar: Paga+shpërblime të djalit E. Ç., administrator i shoqërisë “H. I.” sh.p.k., Tiranë. Të ardhurat në vlerën 1,126,770 lekë.

8.4 Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: Paga+shpërblime të djalit E. Ç., administrator i shoqërisë “H. I.” sh.p.k, Vlorë. Të ardhurat në vlerën 1,449,756 lekë.

8.5 Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: Paga+shpërblime të djalit E. Ç., administrator i shoqërisë “H. I.” sh.p.k., Vlorë. Të ardhurat në vlerën 1,448,851 lekë.

8.6 Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: Paga+shpërblime të djalit E. Ç., administrator i shoqërisë për vitin 2015. Të ardhurat në vlerën 1,800,000 lekë.

8.7 Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: Paga+shpërblime të djalit E. Ç., administrator i shoqërisë “H. I.” sh.p.k. Të ardhurat në vlerën 295,000 lekë.

8.8 QKB-ja me shkresën nr. (*) prot., datë 10.04.2018, drejtuar Komisionit**, ka dërguar informacionin së bashku me dokumentacionin e kërkuar në lidhje me shtetasin E. Ç. nga ku konstatohet se ai figuron i regjistruar si ortak apo administrator në shoqëritë e mëposhtme:

- i. Shoqërinë “B. M. I.” sh.p.k., që më pas bëhet “H. I.” sh.p.k., rezulton se, më datë 23.03.2010, në këtë shoqëri është shtuar ortaku E. Ç., me numër kuotash kapitali 50 %. Më datë 19.04.2010, kanë ndryshuar të dhënat për E. Ç. kontributi në aksione nga 50 % u bë në 33%. Më datë 15.10.2010, kuotat nga 33% u bënë përsëri 50 %. Më datë 08.12.2011, E. Ç., është shtuar si administrator i kësaj shoqërie. Më datë 27.03.2012, është larguar administratori E. Ç. dhe më datë 28.03.2012 është larguar ortaku E. Ç. . Më datë 06.04.2012 është shtuar ortaku E. Ç. me kuota 50 % dhe më datë 04.04.2012 është shtuar si administrator. Më datë 16.01.2013, E. Ç. kuotat i bëhen nga 50 % në 45 %. Më datë 24.04.2015, kuotat e E. Ç. bëhen nga 45 % në 32 %. Më datë 02.06.2017, kuotat e E. Ç. bëhen nga 33 % në 65 %. (Kjo shoqëri aktualisht ka statusin aktiv sipas ekstraktit të datës 21.03.2018).
- ii. Shoqërinë “P. E.” sh.p.k., me NIPT (***), themeluar më datë 01.10.2010, dhe E. Ç. rezulton ortak i kësaj shoqërie me 50 % të aksioneve si dhe është emëruar administrator i kësaj shoqërie, më datë 31.07.2012 deri më datë 31.07.2017. Më datë 24.11.2014, kjo shoqëri u bë me statusin pezulluar (ekstrakti i datë 21.03.2018).
- iii. Shoqërinë “P. G.” sh.p.k, me NIPT (***), nga ku rezulton E. Ç. si ortak i saj që, më datë 27.05.2011, me 50 % të kuotave. Më datë 20.01.2012, E. Ç. bëhet ortak me 100 % të kuotave. Administrator i saj nga data 08.12.2011 deri, më datë 08.12.2016. Më datë 14.02.2012, shoqëria kalon në statusin “Shoqëri në likuidim e sipër” dhe më datë 15.10.2012 çregjistrohet (sipas ekstraktit të datës 21.03.2018).
- iv. Shoqërinë “P. L.” sh.p.k me NIPT (***), nga ku rezulton ortak i kësaj shoqërie që, më datë 25.02.2009, me 20 % të aksioneve të kësaj shoqërie. Më datë 16.06.2009, për E. Ç., përqindja e kuotave ishte 20 % dhe u bë 33 % (sipas ekstraktit të datës 21.03.2018, statusi i saj aktiv).
- v. Shoqërinë “S.” sh.p.k., me NIPT (***), nga ku rezulton ortak i kësaj shoqërie, më datë 18.09.2009, me 80% të kuotave të kapitalit. Më datë 29.12.2010, kjo shoqëri kalon në statusin “Në likuidim e sipër” (sipas ekstraktit të datës 21.03.2018).
- vi. Shoqërinë “A.-I.” sh.p.k, nga ku rezulton se, më datë 30.11.2012, është shtuar ortaku “B. M. I.” sh.p.k., me ortak E. Ç. me 50 % të kuotave të kapitalit. Më datë 19.07.2013, E. Ç., është emëruar administrator i kësaj shoqërie me afat emërimi deri më datë 26.06.2018 (shoqëria ka status aktiv sipas ekstraktit të dt.21.03.2018).
- vii. Shoqërinë “Ç. & P. C.” sh.p.k, me NIPT (***), me ortakë E. Ç. dhe G. Ç., datë 26.01.2017, me administratore G. Ç., emëruar më datë 27.01.2017 deri më datë 27.01.2022 (sipas ekstraktit të datës 21.03.2018 me status aktiv).

8.9 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

8.10 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, aksionet e z. E. Ç. në shoqëritë:

- ✓ “P. L.” sh.p.k;
- ✓ “S.” sh.p.k;
- ✓ “Ç. & P. C.” sh.p.k;
- ✓ “P. E.” sh.p.k;
- ✓ “B. M. I.” sh.p.k.

8.11 Ka mospërputhje deklarimi për sa i përket kohës se kur personi i lidhur/ E. Ç. është bërë ortak pranë shoqërisë “H. I.” sh.p.k., pasi referuar ekstraktit të QKB-së rezulton se, më datë 23.03.2010, në këtë shoqëri është shtuar ortaku E. Ç. me numër kuotash kapitali 50 %, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë fakt vetëm në vitin 2011.

8.12 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar zvogëlimin dhe zmadhimin e kuotave të kapitalit në vitin 2013 dhe 2015 të ortakut E. Ç. në deklaratat periodike të viteve 2013 dhe 2015 të shoqërisë “H. I.” sh.p.k.

8.13 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010, se E. Ç., është ortak me 50,% i shoqërisë “P. E.” sh.p.k., dhe më tej si administrator i saj i emëruar, më datë 31.07.2012, në deklaratën e vitit 2012.

8.14 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 emërimin si ortak të E. Ç., në shoqërinë “P. G.” sh.p.k., me 50 % të kuotave si dhe administrator i saj dhe mosdeklarimin në deklaratën e vitit 2012 të zmadhimit të kapitali 100 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

8.15 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2009, emërimin e E. Ç. si ortak me 20 % të kapitalit të shoqërisë “P. L.” sh.p.k., me 33 % të kuotave të shoqërisë.

8.16 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, emërimin e E. Ç. si ortak me 80 % të kuotave të shoqërisë “S.” sh.p.k.

8.17 Mosdeklarim nga E. Ç. si ortak i shoqërisë “B. M. I.” sh.p.k., në deklaratën e vitit 2012, të emërimit si ortak me 50 % të kuotave të kapitalit në shoqërisë “A.-I.” sh.p.k. Mosdeklarim në deklaratën e vitit 2013 të emërimit të E. Ç. si administrator i saj.

8.18 Lidhur me pretendimet dhe provat që dërgoi subjekti i rivlerësimit, Komisioni, vlerëson se ato nuk provuan të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht të kryer nga Komisioni.

8.19 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklarim të rremë në lidhje me personin e lidhur E. Ç., në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së, në lidhje me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë “H. I.” sh.p.k; ka deklaruar blerjen e 50 % të kapitalit në vitin 2011, në fakt blerja është bërë në vitin 2010. Në vitin 2012, ka shitur 5 % të kuotave, ndërsa në vitin 2015 ka shitur edhe 12% të tyre.

8.20 Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 aksionet e personit të lidhur, z. E. Ç., në shoqëritë:

- ✓ “P. L.” sh.p.k;
- ✓ “S.” sh.p.k;
- ✓ “Ç. & P. C.” sh.p.k;
- ✓ “P. E.” sh.p.k;
- ✓ “B. M. I.” sh.p.k.

8.21 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, E. Ç., kanë fshehur në deklaratimet vjetore, aksionet në shoqëritë e lartpërmendura.

9. Automjet, tip “Renault Megane”, blerë në vlerën 18,500 euro.

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi nga institucionet dhe jo vetëm:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor²¹;
- ✓ Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*);
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

9.1 Në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit deklaroi se ka blerë një makinë pranë “A. S. P.”, tip “Renault Megane”, në vlerën 18,500 euro, paguar pjesërisht nga një kredi e marrë pranë “Tirana Bank”, në vitin 2005 (në vlerën 10,000 euro) dhe pjesërisht nga kursimet e familjes.

9.2 Nga vetë subjekti është depozituar fatura tatimore e lëshuar nga “A. S. P.” sh.p.k., për M. Ç., për blerje automjeti në vlerën 2,220,000 lekë, fatura e blerjes së mjetit në shtetin kroat.

9.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. (*) prot., datë 14.08.2018, ka dërguar dosjen e mjetit me targë (***)**.

9.4 Në përgjigje të pyetësorit të janarit 2019, subjekti deklaroi se, vlera prej 7,000 eurosh është bërë parapagim para nënshkrimit të kontratës në zbatim të pikës 3.4, pjesa tjetër prej 11,500 lekësh është bërë nëpërmjet kredisë së marrë pranë “Tirana Bank”. Subjekti ka bashkëngjitur kontratën dhe pagesat përkatëse. Më tej, subjekti paraqet kontratën lidhur, më datë 15.08.2005, me palë “A. S. P.” sh.p.k., dhe M. Ç., si dhe mandatpagesat.

9.5 Komisioni, mbylli hetimin kryesisht dhe njoftoi subjektin se i ka kaluar barrën e provës për sa vijon:

9.6 Ka mospërputhje deklarimesh të subjektit të rivlerësimit në lidhje me çmimin e blerjes për shkak se:

- ✓ Në deklaratën e vitit 2005, subjekti ka deklaruar çmimin 18,000 euro;
- ✓ Ndërkohë që, në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar çmimin 18,500 euro;
- ✓ Ndërkohë që, referuar faturës tatimore të shitjes lëshuar nga “A. S. P.” për M. Ç., rezultoi çmimi 2,220,000 lekë.

9.7 Nuk dokumentohet pagimi i shumës prej 2,220,000 lekësh nga ana e M. Ç. ndaj shoqërisë “A. S. P.” sh.p.k.

9.8 Ka mospërputhje në lidhje me kohën e blerjes së mjetit, pasi referuar kontratës së shitjes të depozituar nga subjekti në janar të vitit 2019, data e blerjes është 15.08.2005, ndërkohë që dokumentacioni nga DPSHTRR-ja rezultoi se distributori “Renault Nissan Hrvatska” e ka lëshuar faturën për këtë mjet me blerës “A. S. P.”, më datë 26.10.2005.

9.9 Po kështu, sipas kësaj kontrate, deklarohet çmimi i shitjes i cili është 18,490 euro ku, sipas kontratës janë paguar 7,000 euro po, më datë 13.08.2005, ndërsa 11,500 euro janë paguar, më datë 29.10.2005; Mandatarkëtimet e depozituara nga subjekti nuk kanë asnjë nënshkrim apo vulë të shoqërisë “A. S. P.” sh.p.k., por vetëm nënshkrimin e znj. M. Ç.; Në kundërshtim me këto mandate bie dhe fatura tatimore e shitjes së lëshuar nga kjo shoqëri, më datë 23.11.2005, me vlerën 2,220,000 lekë, për automjetin tip “Renault Megane”.

9.10 Kontrata e datës 15.08.2005, nuk rezultoi e depozituar pranë DPSHTRR-së.

9.11 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

²¹ DPSHTRR-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 14.08.2018, ka dërguar dosjen e mjetit me targë (***)

9.12 Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm ndryshimin e çmimit të blerjes që ekzistonte midis deklaramentit dhe dokumentacionit ligjor justifikues, apo dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit për vlerën prej 500 eurosh.

9.13 Në lidhje me kohën e blerjes së mjetit dhe mospërputhjeve që ekzistonin midis dokumentacionit të blerjes, subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm këto mospërputhje.

9.14 Në lidhje me gjetjet e tjera gjatë hetimit, Komisioni, arsyeton se këto mospërputhje kanë ardhur si rezultat i procedurës së ndjekur nga momenti i kontratës së porosisë deri në momentin e dorëzimit të makinës tek personi i lidhur /bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

9.15 **Si konkluzion**, në lidhje me këtë automjet, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarament në lidhje me vlerën dhe mënyrën e pagesës së automjetit.

10. Shpenzimet e kryera për shkollimin e personit të lidhur/vajzës së subjekti të rivlerësimit.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit administroi nga institucionet dhe jo vetëm:

- ✓ Deklaratën “Vetting” për vitin 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017;
- ✓ Deklaratën e interesave periodike vjetore të vitit 2014;
- ✓ Dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”;
- ✓ Shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 11.02.2019.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

10.1 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se në vitin 2014, ka vënë në dispozicion të vajzës G. Ç. shumën prej 17,200 eurosh për shkollim pasuniversitar në Londër.

10.2 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka kryer shpenzime për studime për vajzën G. Ç., në Londër, në shumë prej 11,000 GBP (*pound*).

10.3 Nga dokumentacioni i “Raiffeisen Bank” konstatohet se, më datë 24.06.2014, është hapur një llogari në monedhën *pound* në shumën prej 31,000 + dhe 2,000 GBP që janë depozituar në korrik 2014.

10.4 Pra në total, llogaria për shkollimin e vajzës është në shumën 33,000 GBP, ose e konvertuar në shumën 42,273 euro.

10.5 Komisioni mbylli hetimin kryesisht dhe njoftoi subjektin se i ka kaluar barra e provës për sa vijon:

10.6 Ka mospërputhje në lidhje me shumën e deklaruar e cila është shpenzuar për shkollimin e vajzës, duke krahasuar deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe deklaratën vjetore periodike të vitit 2014, nga njëra anë dhe me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank” nga ana tjetër.

10.7 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se, nga deklarimi i vitit 2014 është deklaruar specifikisht në sektorin e ndryshimeve të pasurive edhe burimi i krijuar: “Në llogarinë “Raiffeisen Bank” janë depozituar, më datë 24.06.2014, shuma prej 31,000 GBP dhe, më datë 30.07.2014, shuma prej 2000 GBP (burimi i tyre ka ardhur nga pakësimi i gjendjes *cash* në shumën prej 6,000,000 lekësh të cilat kanë qenë nga viti i mëparshëm. Gjithashtu, është deklaruar se, më datë 31.07.2014, dhe më datë 31.12.2014, përkatësisht janë tërhequr nga llogaria bankare në “Raiffeisen Bank” shumat prej 11.000 GBP dhe 22.0000 GBP, nga të cilat 11.0000 GBP janë përdorur për shkollimin e vajzës dhe 22.000 GBP janë tërhequr.”

10.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

10.9 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin midis këtyre dokumenteve dhe deklarimeve, pasi nga dokumenti i administruar nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se 22,000 GBP janë tërhequr.

10.10 Si konkluzion, përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar.

VI. SI KONKLUZION PËR KRITERIN E PASURISË

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për vlerësimin e pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2006, për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çeno, Komisioni, arrin në konkluzionin se:

1. Në lidhje me pasurinë, apartament, me sip. 98 m² dhe garazhin me sip. 22 m², subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çeno:

- i. Nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit dhe garazhit.
- ii. Ka fshehur vlerën e blerjes së këtij apartamenti dhe garazhit ndodhur në Rr. “(***)” në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, të vitit 2003.
- iii. Ka kryer deklaram të rremë në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti dhe garazhit në Tiranë.
- iv. Ka kryer deklaram të rremë në lidhje me apartamentin e shitur sipas kontratës nr. (***), datë 21.7.2003, pasi objekti i kësaj kontrate shitjeje nuk është vetëm banesa e përfitur nga privatizimi, por edhe shtesa anësore me sip. 30 m² në pallatin nr.(***), Rr. “(***)”, Durrës.
- v. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi.

2. Në lidhje me pasurinë, apartament, me sip. 79 m² i ndodhur në fshatin K., Komuna Golem, Kavajë, subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çeno:

- i. Nuk shpjegoi bindshëm se përse çmimi i blerjes së këtij apartamenti është nën koston mesatare të ndërtimit të banesave sipas udhëzimit të vitit 2003, duke pasur parasysh këtu edhe faktin se, i njëjti apartament është shitur në vitin 2007 për një vlerë prej 38,000 eurosh.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues nga burime të ligjshme për vitin 2003, në shumën -3,428,871 lekë, për të blerë këtë apartament.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të rremë në lidhje me burimin e krijimit, për shkak se ka deklarime të ndryshme në periudha të ndryshme.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë apartament.

3. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme të personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit, apartament, me sip.144 m², ndodhur në Rr. “(*)”, pallati “(***)”, Tiranë subjekti i rivlerësimit:**

- i. Ka fshehur vlerën e pasurisë (apartament + garazh), të porositur me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “Sh.” sh.p.k., në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, ashtu edhe në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së.
- ii. Ka fshehur vlerën reale të detyrimit të mbetur shoqërisë. Detyrimi i mbetur, referuar pagesave të deklaruara nga subjekti, rezulton të jetë në vlerën 27,000 euro, ndërsa sipas

deklarimeve ndër vite dhe deklarimit nga ana e shoqërisë, rezulton të jetë në vlerën 19,000 euro. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga ana e subjektit, në lidhje me pagesat e kryera.

- iii. Ka kryer deklarim të rremë në lidhje me likuidimet ndaj shoqërisë “Sh.” sh.p.k., për blerjen e apartamentit dhe garazhit, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë shoqëria “Sh.” sh.p.k., pagesa e parë me këtë shoqëri është bërë në vitin 2008, në shumën 3.700.000 lekë, ndërsa është deklaruar nga subjekti si pagesë e bërë në vitin 2009.
- iv. Ka mungesë burimesh të ligjshme financiare në vitin 2008, për pagesën e shumës 3,700,000 lekë ose rreth 30,000 euro.

4. Në lidhje me pasurinë, tokë ullishte, me sip. 3000 m², ndodhur në Sh., Durrës dhe sip. 2775 m², po në Sh., Durrës, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, nuk provoi me anë të shpjegimeve apo dokumenteve mospërputhjet që ekzistojnë midis deklarimit të tij dhe dokumentacionit të administruar në dosje, për mënyrën e fitimit të pronësisë së këtij aseti.

5. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, apartament, me sip. 91.51 m², ndodhur në Golem, Kavajë, subjekti i rivlerësimit:

- i. Ka fshehur dhe ka kryer deklarim të rremë në deklaratat e interesave private të viteve 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, në lidhje me apartament dhe vendparkim, në Golem, Kavajë.
- ii. Ka fshehur në deklaratën e interesave private të vitit 2012, blerjen dhe kalimin e pronësisë së truallit të pronës në Golem, Kavajë.
- iii. Nuk justifikon me dokumentacion ligjor justifikues se kur janë paguar ekzaktesisht këstet e këtij apartamenti.
- iv. Ka fshehur në deklaratën periodike të vitit 2012, kontratën “Shitje për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit”, me shitës ALUIZNI dhe blerës M. Ç. për kalimin e truallit dhe ndërtimit në pronësi të znj. M. Ç., ku ka paguar vlerën prej 158,412 lekësh të parcelës ndërtimore, vlerë kjo e padeklaruar.
- v. Shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistojnë mbi sipërfaqen e ndërtimit në aktmarrëveshjen, datë 06.06.2007, të porosisë dhe kontratës së shitjes në vitin 2014.

6. Në lidhje me kredinë në vlerën prej 80,000 eurosh, marrë nga banka “Societe Generale Albania”, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten dhe djalin E. Ç.:

- i. Kanë kryer deklarim të rremë ndaj bankës “Societe Generale Albania”, në lidhje me destinacionin e përdorimit të kredisë.
- ii. Kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për të vërtetuar likuidimin e kësteve të kredisë nga shoqëria “H. I.” sh.p.k., si përfituese indirekte e kredisë.
- iii. Subjekti ka kryer deklarim të rremë në deklaratën e vitit 2012 për kredinë e marrë pranë “Societe Generale Albania” për strehim, pasi është fshehur apartamenti që do përfitohej, po ashtu edhe revokimi i kontratës për apartamentin, si dhe kalimi i kredisë në favor të shoqërisë “H. I.” sh.p.k.
- iv. Subjekti ka fshehur dhe kryer deklarim të rremë në deklaratën e vitit 2013 për shlyerjet e kredisë pranë “Societe Generale Albania”, pasi nga dokumentet rezulton se kredia ka kaluar që në vitin 2012 në favor të shoqërisë “H. I.” sh.p.k., por nuk është shlyer.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, faktin që është akoma bashkëkredimarrës në këtë kredi.

7. Në lidhje me deklarimin e personit të lidhur, djalit të subjektit të rivlerësimit, E. Ç., subjekti i rivlerësimit:

- i. Ka kryer deklarin të rremë në lidhje me personin e lidhur, z. E. Ç., në deklaratat ndër vite pranë ILDKPKI-së, në lidhje me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë “H. I.” sh.p.k; ka deklaruar blerjen e 50 % të kapitalit në vitin 2011, në fakt blerja është bërë në vitin 2010. Në vitin 2012, ka shitur 5 % të kuotave, ndërsa në vitin 2015 ka shitur edhe 12 % të tyre.
- ii. Ka fshehur në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, aksionet e personit të lidhur, z. E. Ç., në shoqëritë:
 - ✓ “P. L.” sh.p.k;
 - ✓ “S.” sh.p.k;
 - ✓ “Ç. & P. C.” sh.p.k;
 - ✓ “P. E.” sh.p.k;
 - ✓ “B. M. I.” sh.p.k.
- iii. Ka fshehur në deklarinimet vjetore, aksionet në shoqëritë e lartpërmendura.

8. Në lidhje me automjetin, tip “Renault Megane”, blerë në vlerën 18,500 euro, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarin në lidhje me vlerën dhe mënyrën e pagesës së automjetit.

9. Shpenzimet e kryera për shkollimin e personit të lidhur/vajzës së subjekti të rivlerësimit, përputhet deklarinimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që, subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar si dhe të nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çeno, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohehet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 27.02.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Olsi KOMICI
Anëtar

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Denisa Kosta
Sekretare gjyqësore